

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Viti i 93-të i botimit
Shtator-tetor 2025 / Nr. 3

Mbrojtja



REVOLUCIONI I MBROJTJES

Teknologji, Partneritet
dhe Vizion i Ri për Sigurinë

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Viti i 93-të i botimit SHTATOR-TETOR 2025 / Nr. 3

DREJTOR I QKMBM
ARBEN SKENDERAJ

Shefe e Sektorit të Botimeve &
Kryeredaktore
ANJEZA MUSOLLARI

GRAPHIC DESIGNER
AFËRDITA HYSAJ

REDAKTORE / KORREKTORE
SUELA HODA

BASHKËPUNËTORE

KOLONEL HYSNI GJERGJI

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

© Ministria e Mbrojtjes

*Materialet e publikuara në këtë revistë nuk mund të
riprodhohen elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitim, pa marrë
autorizim nga botuesit e saj.*

Botues:
Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes.

Adresa:
Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:
<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>



Mbrojtja

Ministri i Mbrojtjes Vengu: Diplomacia shqiptare, dimension i ri për industrinë ushtarake dhe sigurinë rajonale	4
Karta e Adriatikut: Shqipëria rrit rolin e saj strategjik në sigurinë euro-atlantike	6
Mbrojtja Civile në fokus të qeverisë: Inovacion, reagim dhe siguri	10
Shqipëria ngjitet në 2% të mbrojtjes: Rama dhe Rutte konfirmojnë aleancën e fortë me NATO-n	14
60-vjetori i Batalionit të Mbështetjes: Njësi elitë e Forcave të Armatosura, simbol i transformimit dhe përkushtimit	16
Ministri Vengu: Reformimi i Forcës Tokësore, një domosdoshmëri për Modernizimin dhe Sigurinë e Shqipërisë	18
Ministri Vengu: Shqipëria ngjitet në vendin e 15-të në botë për sigurinë kibernetike	22
Forcat e Armatosura të Shqipërisë thellojnë bashkëpunimin me NATO-n në fushën e standardizimit	24
Qendra e Personel Rekrutimit hap dyert me pamje të re dhe kushte moderne pune	26
Inovacioni në qendër të vizionit të Ministrisë së Mbrojtjes: Ministri Vengu në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes	28
BMEC shënon 38-vjetorin e krijimit, ministri Vengu vlerëson kontributin e saj në mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve shqiptarë	32
SHSHPPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji: Uniteti, garancia më e fortë për paqe e stabilitet në Ballkanin Perëndimor	38
Horizont Blu: Forca Detare, shtylla e sigurisë dhe e së ardhmes detare të Shqipërisë	44
Mendimi kritik, arma e heshtur e ushtarakut modern	48
Fjongo Rozë mbi Uniformë: Historia e guximit, shpresës dhe ringritjes	54
Mbrojtja Civile Shqiptare: Historia, Sfida dhe Angazhimi për Sigurinë e Qytetarëve në Kohë Krize	58
Hipokrizia, maska e njerëzimit në kohën moderne	62
Gratë që mbajtën kombin mbi supe: Nga Nora e Kelmendit te Nënë Tereza	64
Drejt vitit 2030 me "Luftë pa kontakt"	66
Barazia që vonon: Gruaja shqiptare në betejë me stereotipat	74
Lufta e Arbanës	80

35

**Gjenerallejtënant
Arben Kingji në
Takimin e Komitetit
Ushtarak të NATO-s
në Riga: Shqipëria,
e angazhuar për
modernizimin dhe
sigurinë rajonale**

16

60-vjetori i Batalionit të Mbështetjes: Njësi elitë e Forcave të Armatosura, simbol i transformimit dhe përkushtimit

12

“48 sulme, asnjë dëm”, Rama në Konferencën e NATO-s: Shqipëria ndër më të mbrojturat falë inteligjencës artificiale

4

Ministri i Mbrojtjes Vengu: Diplomacia shqiptare, dimension i ri për industrinë ushtarake dhe sigurinë rajonale



INTERVISTA

Fjongo Rozë mbi Uniformë: Historia e guximit, shpresës dhe ringritjes

Faqe 54



Mbrojtja Civile Shqiptare: Historia, Sfida dhe Angazhimi për Sigurinë e Qytetarëve në Kohë Krize

Faqe 58



Uniforma që Formon Njerëz: Nga agimi i Bunavisë te Betimi për Atdheun

Faqe 52

Ministri i Mbrojtjes Vengu: Diplomacia shqiptare, dimension i ri për industrinë ushtarake dhe sigurinë rajonale



Ministri i Mbrojtjes
PIRRO VENGU

Në një kohë kur mbrojtja dhe diplomacia janë të ndërthurura më fort se kurrë, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, mbajti një fjalë të posaçme përpara ambasadorëve shqiptarë në botë, gjatë takimit të zhvilluar në Tiranë.

Në fjalën e tij, ministri theksoi se rilindja e industrisë ushtarake shqiptare përbën një nga prioritetet madhore të



qeverisë, duke e cilësuar si një sektor strategjik që do të ndikojë drejtpërdrejt jo vetëm në forcimin e kapaciteteve të mbrojtjes, por edhe në rritjen e rolit ndërkombëtar të vendit tonë. “Modernizimi i kapaciteteve të luftimit është një domosdoshmëri përballë kërcënimeve të reja të sigurisë. Kjo kërkon jo vetëm investime në teknologji dhe pajisje, por edhe një ndërveprim të vazhdueshëm me aleatët tanë strategjikë”, - u shpreh ministri.

Ai shtoi se kërcënimet hibride, sfidat e sigurisë kibernetike dhe teknologjitet e avancuara po ndryshojnë mënyrën se si shtetet duhet të organizojnë mbrojtjen e tyre, duke e bërë të domosdoshme një qasje gjithëpërfshirëse, ku diplomacia luan një rol po aq të rëndësishëm sa edhe forcat e armatosura.

Ministri Vengu theksoi gjithashtu se ambasadorët shqiptarë duhet të jenë zëri i ri i diplomacisë së mbrojtjes, duke përçuar tek

partnerët ndërkombëtarë rolin e Shqipërisë si faktor sigurie në Evropën Juglindore. “Detyra juaj është të bëni të njohur kontributin e Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut, pjesëmarrjen tonë në misionet paqeruajtëse dhe mundësitë e reja që hap rilindja e industrisë ushtarake për bashkëpunim rajonal dhe ndërkombëtar”, - u shpreh ai.

Duke iu referuar kontekstit rajonal, ministri nënvizoi se Shqipëria mbetet e përkushtuar për stabilitetin dhe paqen në Ballkanin Perëndimor, duke e parë partneritetin me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-n si garancinë kryesore për sigurinë kombëtare dhe rajonale.

Fjala e ministrit u përmbyll me një apel të qartë: “Mbrojtja dhe diplomacia nuk janë më dy fusha të ndara. Ato duhet të ecin paralelisht, të përforcojnë njëra-tjetrën dhe të bëjnë Shqipërinë një aktor më të fortë në skenën ndërkombëtare.”

Karta e Adriatikut: Shqipëria rrit rolin e saj strategjik në sigurinë euro-atlantike



**Ministri i Mbrojtjes
PIRRO VENGU**

Në Konferencën e 28-të të Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të Kartës së Adriatikut (SHBA-A5), zhvilluar në Tiranë, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu theksoi angazhimin e Shqipërisë për forcimin e sigurisë rajonale dhe pozicionimin e vendit si një qendër të besueshme për industrinë e mbrojtjes.

Ministri Vengu nënvizoi se Shqipëria po investon në ngritjen e një infrastrukture ushtarake që i përgjigjet standardeve të NATO-s.

Ai theksoi rëndësinë e rritjes së burimeve financiare për buxhetet e mbrojtjes dhe zgjerimin e industrisë së mbrojtjes dhe prodhimit ushtarak si hapa të



domosdoshëm për modernizimin e Forcave të Armatosura.

Një nga objektivat kryesore të Shqipërisë, sipas Ministrit Vengu, është pozicionimi i vendit si një qendër e besueshme për industrinë e mbrojtjes. Gjithashtu, ai theksoi rëndësinë e lidhshmërisë dhe ndërveprimit ushtarak në rajonin e Adriatikut dhe Evropën Juglindore si pjesë e strategjisë për forcimin e sigurisë euro-atlantike.

“Karta e Adriatikut lindi si vizion i bashkëpunimit dhe stabilitetit euroatlantik. Në një mjedis strategjik që ndryshon me shpejtësi, ne duhet të përshtatemi dhe të ripërtërijmë misionin e saj”, - u shpreh Vengu, duke nënvizuar se pjesëmarrja e Shteteve të Bashkuara e bën këtë nismë të pazëvendësueshme për sigurinë rajonale.

Më tej ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu parashtroi pesë prioritetet kryesore të Shqipërisë për forcimin e mbrojtjes:

- Rritja e buxhetit të mbrojtjes
- Zgjerimi i industrisë së mbrojtjes dhe prodhimit ushtarak
- Modernizimi i Forcave të Armatosura me aftësi vdekjeprurëse dhe përdorim të dyfishtë
- Investimi në infrastrukturën kritike dhe kapacitetet pritëse
- Forcimi i ndërveprimit me aleatët përmes stërvitjeve dhe operacioneve të përbashkëta

“Shqipëria mbetet e angazhuar në misionet ndërkombëtare të NATO-s dhe BE-së, duke kontribuar me rreth 500 trupa në misionet e KFOR-it, ALTEA-s dhe në Letoni dhe Bullgari. Ky angazhim është një shenjë e përkushtimit të Shqipërisë për stabilitetin dhe sigurinë rajonale.

Kosova duhet të përfshihet plotësisht dhe formalisht si anëtare e natyrshme e Kartës së Adriatikut, përfshirja e Kosovës është e rëndësishme për forcimin e bashkëpunimit dhe stabilitetit rajonal. Qëllimi ynë është ta pozicionojmë Shqipërinë si një qendër të besueshme për industrinë e mbrojtjes, një nyje kyçe të lëvizshmërisë dhe bashkëpunimit ushtarak në Adriatik dhe në të gjithë Evropën Juglindore”, - mbylli fjalën e tij ministri Vengu.





Ministri Vengu në Bratislavë: Shqipëria, faktor stabiliteti dhe sigurie në rajon



Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, mori pjesë në Takimin e Ministrave të Mbrojtjes të Europës Qendrore dhe Ballkanit Perëndimor (CEDC+WB), i zhvilluar këtë vit në Bratislavë të Sllovakisë.

Konferenca kishte në fokus industrinë e mbrojtjes, modernizimin dhe armatimin, si prioritetet kryesore të presidencës sllovaqe.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi se Shqipëria është një prodhues stabiliteti dhe sigurie në rajon, falë më shumë se 500 trupave të angazhuara në misionet e NATO-s dhe Bashkimit Europian, si dhe përmes investimeve të rëndësishme në industrinë e mbrojtjes. Këto përfshijnë prodhimin e sistemeve të artillerisë, dronëve luftarakë, mjeteve të blinduara dhe municioneve.

Ai nënvizoi se këto investime lidhen ngushtësisht me infrastrukturën kritike kombëtare, si Korridori VIII, Porto Romano dhe forcimin e Mbrojtjes Civile:

“Në këndvështrimin tonë, axhenda e anëtarësimit në Bashkimin Europian dhe fuqizimi i mbrojtjes, si një shtyllë zhvillimi ekonomik dhe qëndrueshmërie kombëtare, shkojnë krah për krah. Ky ishte momenti për të marrë mbështetje domethënëse nga të gjithë kolegët e Europës Qendrore dhe Juglindore për këtë përparësi kombëtare”, – u shpreh ministri Vengu.

Në punime morën pjesë ministrat e Mbrojtjes së Austrisë, Kroacisë, Çekisë, Hungarisë, Sllovakisë, Sllovenisë, si dhe homologët nga vendet e Ballkanit Perëndimor: Bosnja-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia.



Ministri Vengu: Shpërblime prej 1 deri në 3 paga mujore për punonjësit e luftës kundër zjarreve, si vlerësim i misionit të tyre fisnik



Këshilli i Ministrave miratoi një vendim të ri për shpërblimin e punonjësve të angazhuar në luftën kundër zjarreve në vend. Sipas

këtij vendimi, punonjësit e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Policisë së Shtetit, Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, si dhe shërbimeve të mbrojtjes nga zjarri në bashki, do të shpërblehen me nga 1 deri në 3 paga mujore në varësi të angazhimit dhe rolit të tyre në situata emergjente. Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, duke shprehur vlerësimin për kontributin e punonjësve të këtij sektori, tha se ky vendim është një vlerësim i merituar për misionin fisnik dhe përpjekjet e shumta të këtij personeli, të cilët shpeshherë veprojnë me vetëmohim në luftën e pabarabartë kundër flakëve. “Ky vendim është një shenjë e qartë e vlerësimit tonë për punën e palodhur dhe sakrificat e punonjësve të sektorit të mbrojtjes nga zjarri. Ata janë heronj të paepur në situata kritike dhe ky shpërblim është një motivim i rëndësishëm për ta”, - tha ministri Vengu. Vendimi i ri synon të forcojë motivimin dhe luftën kundër zjarreve, duke përforcuar rolin e kësaj strukture në mbrojtje të jetëve dhe pasurive të qytetarëve shqiptarë.



Mbrojtja Civile në fokus të qeverisë: Inovacion, reagim dhe siguri



Transformim i thellë i Forcës Zjarrfikëse - Kapitull i ri për Mbrojtjen Civile

Në Bazën Ajrore të Farkës u prezantua projekti i ri i qeverisë për transformimin e Forcës Zjarrfikëse, që shënon hapjen e një kapitulli të ri për Mbrojtjen Civile në Shqipëri. Projekti synon modernizimin e strukturave dhe pajisjeve të emergjencës, duke vënë në qendër inovacionin dhe teknologjinë për përballimin më efektiv të fatkeqësive natyrore.

Në aktivitetin e zhvilluar morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu, ministrja e Punëve të Brendshme Albana Koçiu, ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor Ervin Demo, si dhe përfaqësues të Forcave të Armatosura, Policisë së Shtetit dhe Forcave Zjarrfikëse.

Gjatë fjalës së tij, kryeministri Rama theksoi angazhimin e qeverisë për dëmshpërblim të

plotë për qytetarët e prekur nga zjarret e verës, si dhe nisma të reja ligjore që do të nxisin sigurimin e banesave dhe bizneseve kundër fatkeqësive natyrore. Ai paralajmëroi masa më të ashpra kundër zjarrvënësve, përfshirë ndalimin e çdo leje ndërtimi për 30 vite në territoret e djegura, dhe bëri të ditur se zjarrfikësit do të përfshihen në formulën e rritjes së pagave të Forcave të Armatosura.

Nga ana e tij, ministri i Mbrojtjes Pirro Vengu vuri në dukje se sezoni i fundit i zjarreve ka ofruar mësim të rëndësishme për menaxhimin e emergjencave, duke theksuar nevojën për një sistem të integruar që mbulon jo vetëm zjarret, por edhe përmbytjet, tërmetet dhe situata të tjera të rrezikut civil.

Ministri prezantoi tre shtyllat kryesore mbi të cilat do të ndërtohet programi i ri i Mbrojtjes Civile:

Kapitali njerëzor – forcimi i zinxhirit reagues që nga niveli vendor dhe krijimi i qendrave rajonale të emergjencave.

Inovacioni teknologjik – përfshirja e teknologjive të avancuara, si përdorimi i kamerave termike dhe mjeteve ajrore, që kanë treguar efektivitet të lartë



në raste si ai i Llogorasë.

Efiçenca financiare – optimizimi i përdorimit të fondeve që bashkitë kanë në dispozicion për menaxhimin e emergjencave.

“Sistemi i menaxhimit të emergjencave duhet të jetë i gjallë dhe i shtrirë në çdo cep të vendit për të garantuar reagim të shpejtë dhe të koordinuar ndaj çdo rreziku”, – u shpreh ministri Vengu.

Në vijim, ministrja Koçiu dhe ministri Demo prezantuan pasqyrën e angazhimit të institucioneve përkatëse në forcimin e kapaciteteve njerëzore, zgjerimin e flotave operacionale dhe investimet infrastrukturore që do të rrisin aftësinë reaguese të sistemit të Mbrojtjes Civile në rang kombëtar.



“48 sulme, asnjë dëm”, Rama në Konferencën e NATO-s: Shqipëria ndër më të mbrojturat falë inteligjencës artificiale

Në Tiranë u zhvillua Konferenca Kibernetike e NATO-s, ku në qendër të diskutimeve ishin sfidat dhe bashkëpunimi i vendeve aleate për përballimin e kërcënimeve në hapësirën kibernetike.





Kryeministri Edi Rama theksoi se Shqipëria përballlet çdo tre minuta me sulme kibernetike, por falë investimeve në teknologji dhe inteligjencë artificiale, asnjë prej tyre nuk ka shkaktuar dëme serioze.

“Gjatë këtij viti kemi pasur 48 sulme që kanë lënë gjurmë, por pa asnjë dëm të konsiderueshëm. Infrastruktura jonë digjitale dhe fizike është sot mes më të mbrojturave, falë ndërthurjes së mbrojtjes kibernetike me inteligjencën artificiale, që punon 24 orë në ditë për të zbuluar në faza të hershme çdo kërcënim”, - deklaroi Rama.

Kryeministri Rama theksoi se Shqipëria është ndër vendet e para që ka integruar AI-në në mbrojtjen kibernetike, duke e kthyer këtë teknologji në një mur inteligjent mbrojtës. Ai shtoi se vendi ynë ka bërë një kapërcim të madh në digjitalizim, duke i ofruar qytetarëve 95% të shërbimeve publike online, pa nevojën për sportele fizike.

“Me këtë investim, kemi lënë pas një histori rryshfetesh dhe kemi ndryshuar marrëdhënien mes qeverisë dhe qytetarëve”, - tha Rama.

Në konferencë, foli përmes një video-mesazhi edhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, i cili theksoi rëndësinë



e bashkëpunimit dhe reagimit të përbashkët në fushën kibernetike. Ai njoftoi ngritjen e një Qendre të Integruar Kibernetike të NATO-s në Belgjikë, që do të monitorojë dhe informojë të gjitha komandat e Aleancës për kërcënimet e mundshme. “Sot tastiera është armë luftar. Aktorë shtetërorë dhe jo shtetërorë përpiqen çdo ditë të dëmtojnë infrastrukturën tonë. NATO po bëhet gjithnjë e më e fortë në këtë fushë dhe çdo sulm ndaj një vendi të Aleancës mund të aktivizojë Nenin 5 - një sulm ndaj njërit është sulm ndaj të gjithëve”, - theksoi Rutte.

Kreu i NATO-s nënvizoi gjithashtu se asnjë vend nuk është vetëm në Aleancë, dhe se bashkëpunimi në mbrojtjen dixhitale është thelbësor për sigurinë kolektive.

Në përmbyllje, Kryeministri Rama apeloi për veprim të përbashkët dhe parandalim proaktiv ndaj sulmeve kibernetike: “Nuk duhet të presim të sulmohemi për të vepruar. Duhet të jemi bashkë, sepse rreziku është real dhe vetëm së bashku mund ta përballojmë”. Konferenca Kibernetike e NATO-s në Tiranë vjen në një kohë kur hapësira dixhitale po kthehet në fushë strategjike të mbrojtjes, ku teknologjia dhe inteligjenca artificiale po marrin një rol vendimtar në sigurinë kombëtare dhe atë ndërkombëtare.

Shqipëria ngjitet në 2% të mbrojtjes: Rama dhe Rutte konfirmojnë aleancën e fortë me NATO-n

Rama takon në Bruksel Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte: Shqipëria arrin objektivin 2% dhe synon ndërtimin e portit të ri ushtarak në Porto Romano



Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim zyrtar në Bruksel me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, në selinë e Aleancës së Atlantikut të Veriut. Diskutimet u përqendruan te roli i Shqipërisë në NATO, kontributi ndaj sigurisë euroatlantike, ndihma për Ukrainën dhe projektet strategjike për zhvillimin e industrisë së mbrojtjes.

Sekretari i Përgjithshëm Rutte vlerësoi lart angazhimin e Shqipërisë si një partner i fortë i NATO-s, duke theksuar se vendi ynë këtë vit do të arrijë objektivin e 2% të shpenzimeve për mbrojtjen, një standard i vendosur nga Aleanca. Ai theksoi gjithashtu se Shqipëria ka luajtur një rol aktiv përtej madhësisë së saj si shtet, si brenda vendit ashtu edhe jashtë kufijve.

“Është një nder i madh të kem këtu mikun tim të ngushtë, Edi Ramën, Kryeministrin e Shqipërisë. Shqipëria është një aleat i fortë. Shqipëria këtë vit do të arrijë nivelin 2% të shpenzimeve

për mbrojtjen, që është një angazhim i madh. Ju po bëni shumë sa i përket ndihmës për Ukrainën dhe jeni aktivë në Letoni, Bullgari e Kosovë. Shqipëria nuk është aleati më i madh, por po jep një kontribut shumë më të madh se sa madhësia e saj. Ne e dimë që NATO mund të mbështetet gjithmonë te Shqipëria”, - u shpreh Rutte.

Ai nënvizoi gjithashtu rëndësinë e zhvillimit të industrisë së mbrojtjes në Shqipëri, duke përmendur ndërmarjen shtetërore dhe projektet që synojnë krijimin e një baze më të fortë industriale në kuadër të Aleancës. Sipas tij, ky zhvillim është jetik për sigurinë e përbashkët dhe për mbështetjen që NATO i jep Ukrainës.

Nga ana e tij, Kryeministri Rama falënderoi për mikpritjen dhe vlerësimin, duke riafirmuar vendosmërinë e Shqipërisë për të thelluar kontributin e saj në sigurinë kolektive.

“Është gjithmonë kënaqësi të jemi këtu, jo vetëm për shkak të miqësisë sonë të gjatë, por sepse gjithmonë ka diçka për të mësuar. Ne jemi këtu për të rikonfirmuar gjithçka që u tha dhe për të bërë më shumë. Shqipëria po hedh bazat për rilindjen e industrisë sonë ushtarake dhe synon të japë një kontribut më të madh në NATO”, - deklaroi Rama.

Kreu i qeverisë ndaloj veçanërisht te një nga projektet më strategjike që Shqipëria synon të realizojë në partneritet me Aleancën: ndërtimi i një porti të ri ushtarak në Porto Romano. Ai e cilësoi këtë si një hap të rëndësishëm për rritjen e kapaciteteve ushtarake të vendit dhe për sigurinë rajonale.

“Jemi shumë të interesuar të diskutojmë me ju hapat e mëtejshëm për ndërtimin e portit të ri ushtarak në Porto Romano. Gjithashtu, duam të shqyrtojmë mundësinë e përfshirjes në programin ‘Safe’ të Bashkimit Evropian, i cili mund të jetë i dobishëm edhe për vendet e NATO-s”, - theksoi Rama.

Takimi u mbyll me konfirmimin e dyanshëm se Shqipëria mbetet një partner i besueshëm dhe i angazhuar në kuadër të Aleancës, ndërsa NATO garanton mbështetje të plotë për vendin tonë. Vizita e Kryeministrit Rama në Bruksel ishte dyditore dhe u shoqërua me një tjetër zhvillim të rëndësishëm për procesin e integritetit evropian. Të mërkurën, Shqipëria mori zyrtarisht “dritën jeshile” për hapjen e grup-kapitullit të pestë në negociatat me BE-në, atë të “Afhendës së Gjellbër dhe Ndërlidhjes së qëndrueshme”, duke shënuar pesë nga gjashtë grup-kapitujt e hapur brenda vetëm 11 muajve.





60-vjetori i Batalionit të Mbështetjes: Njësi elitë e Forcave të Armatosura, simbol i transformimit dhe përkushtimit



Me një ceremoni solemne, ku morën pjesë personalitetet më të larta të shtetit dhe Forcave të Armatosura, u shënua 60-vjetori i krijimit të Batalionit të Mbështetjes. Në këtë aktivitet morën pjesë Presidenti i Republikës dhe Komandant i Përgjithshëm i FA-ve, Sh.T. z. Bajram Begaj, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, si dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-ve, gjeneralletënant Arben Kingji.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, theksoi rëndësinë historike të këtij përvjetori, duke e cilësuar batalionin si një nga shtyllat kryesore në procesin e transformimit të FA-ve dhe shtet-ndërtimit të Shqipërisë gjatë tranzicionit.

“60-vjetori i Batalionit të Mbështetjes është një pikë kulmore në historinë e kësaj njësie, për vetë faktin se ajo ka shoqëruar Shqipërinë moderne në të gjitha etapat e



transformimit të FA-ve dhe të shtet-ndërtimit tonë. Synimi ynë është rikthimi i përgjegjësisë së këtij batalioni për sigurinë e kryeqytetit dhe infrastrukturës kritike. Ky batalion ka qenë edhe një shkollë komandimi, nga e cila kanë dalë shumë drejtues të Forcave të Armatosura”, – u shpreh ministri Vengu.

Ministri falënderoi komandantët dhe efektivët ndër vite për profesionalizmin, përkushtimin dhe sakrificat, duke theksuar se modernizimi dhe fuqizimi i batalionit do të mbeten një objektivi i përhershëm.

Nga ana e tij, Presidenti Begaj vlerësoi këtë njësi si një njësi elitë të modernizuar të Forcave të Armatosura, duke përmendur përkushtimin dhe disiplinën e efektivëve.

“Ky rrugëtim gjashtë dekadash është shtruar me sakrifica, por është kurorëzuar me dinjitet. Arritjet tuaja kanë ardhur nga stërvitja, disiplina dhe besnikëria ndaj trinomin të shenjtë: detyrë

– nder – atdhe. Ky parim ka qenë busulla morale e çdo brezi ushtarak.

Sot, ashtu si ky batalion, edhe FA-të kanë hyrë në një epokë të re më moderne në pajisje e aftësi dhe më të respektuara në shoqërinë shqiptare”, – u shpreh kreu i shtetit.

Presidenti Begaj gjithashtu nënvizoi rolin e Shqipërisë në misionet ndërkombëtare të NATO-s, Kombeve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian, duke theksuar se FA-të shqiptare janë sot një faktor i rëndësishëm sigurie.

Në këtë ceremoni, komandanti i batalionit, nënkolonel Orges Shuraja, shprehu angazhimin e efektivëve për të vijuar me të njëjtin profesionalizëm dhe përkushtim.

Të pranishëm ishin gjithashtu gjeneralë, ish-komandantë dhe pjesëtarë të trupës që kanë dhënë kontribut ndër vite, duke i dhënë aktivitetit një dimension të veçantë historik e simbolik.



Ministri Vengu: Reformimi i Forcës Tokësore, një domosdoshmëri për Modernizimin dhe Sigurinë e Shqipërisë



Në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, në Zall-Herr, u zhvillua një ceremoni e veçantë për të përkujtuar krijimin e kësaj strukture të rëndësishme të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Të pranishëm në aktivitet ishin: ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji, drejtues të lartë ushtarakë, përfaqësues të trupës dhe personelit civil të FA-së.

Në fjalën e tij, ministri Vengu theksoi rëndësinë historike të themelimit të Komandës së Forcës Tokësore, duke e cilësuar atë një akt të domosdoshëm për ringritjen e ushtrisë shqiptare dhe konsolidimin e shtetit pas periudhave të vështira.

“Ristrukturimi i Forcës Tokësore nuk ishte një akt formal. Ishte një nisje nga e para, një domosdoshmëri pa të cilën Shqipëria nuk do të ishte sot ajo që është. Uniforma nuk është vetëm një shenjë dalluese, por një



mburojë për vendin dhe një shërbim i përditshëm ndaj shoqërisë”, – u shpreh ministri Vengu, duke nënvizuar rëndësinë e modernizimit të FA-ve dhe investimeve në infrastrukturë e kapital njerëzor.

Gjeneralmajor Ilir Xhebexhia, komandant i Forcës Tokësore, në fjalën e tij vlerësoi përkushtimin e çdo efektivit si burimin kryesor të forcës së kësaj strukture:

“Ky jubile është dëshmi konkrete e rrugëtimit institucional të FA-së në ndërtimin e kapaciteteve elitare dhe konsolidimin e një force të përgatitur për të përmbushur misionin dhe detyrat brenda e jashtë vendit. Por mbi të gjitha, forca jonë jeni ju, çdo ushtar, çdo oficer, çdo familje që mbështet sakrificën tonë”.


Ceremoninë e përshëndeti gjithashtu gjeneralmajor në rezervë, Nazmi Cahani, ish-komandant i Forcës Tokësore, i cili shprehu krenari dhe mirënjohje për përkushtimin dhe sukseset e ushtarakëve ndër vite.

Në përfundim të aktivitetit, të pranishmit patën mundësi të njiheshin nga afër me një pjesë të mjeteve, pajisjeve dhe armatimeve

moderne në përdorim nga Forca Tokësore, duke reflektuar standardin e lartë të gatishmërisë dhe profesionalizmit të saj.



Kryeministri Rama, ministri i Mbrojtjes Vengu dhe shefi i Shtabit Kingji, në takime me Admiralin amerikan Munsch: Rilindja e industrisë ushtarake, siguria rajonale dhe partneriteti strategjik me SHBA



Kryeministri Edi Rama zhvilloi një takim me Komandantin e Forcave Detare të Shteteve të Bashkuara në Europë dhe Afrikë, Admiralin Stuart B. Munsch. Takimi u zhvillua në kuadër të hapave që Shqipëria po ndërmerr për rilindjen e industrisë ushtarake, si dhe për ecurinë e projekteve madhore si Korridori VIII dhe Porti i Ri i Durrësit.



**Admirali Stuart B. Munsch
vlerësoi rolin konstruktiv të
Shqipërisë dhe Forcave të
Armatosura si faktor paqeje
dhe stabiliteti në rajon dhe
më gjerë, si edhe kontributin
e trupave tona në misionet
e NATO-s, veçanërisht
në Kosovë.**

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, në këtë takim theksin e vuri mbi thellimin e bashkëpunimit strategjik në fushën e mbrojtjes, si dhe mbi përfshirjen e Shqipërisë në projekte të përbashkëta të sigurisë dhe mbrojtjes rajonale.

Në vijim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, u fokusuan mbi zhvillimet në Forcat e Ar-

matosura të Republikës së Shqipërisë, situatën e sigurisë në rajon dhe forcimin e bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Gjeneral-lejtënant Kingji nënvizoi rolin thelbësor të pranisë së KFOR-it në Kosovë si garanci për sigurinë dhe stabilitetin afatgjatë rajonal, duke e konsideruar këtë mision të pazëvendësueshëm. Ai vlerësoi mbështetjen e SHBA-ve, sidomos përmes partneritetit të qëndrueshëm me Gardën Kombëtare të Nju Xhersit.

Nga ana e tij, Admirali Stuart B. Munsch vlerësoi rolin konstruktiv të Shqipërisë dhe Forcave të Armatosura si faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë, si edhe kontributin e trupave tona në misionet e NATO-s, veçanërisht në Kosovë.

Gjatë vizitës së tij njëditore në vendin tonë, Admirali Munsch zhvilloi takime edhe me Komandantin e Forcës Detare, nënadmiral Adnand Agastra.

Ministri Vengu: Shqipëria ngjitet në vendin e 15-të në botë për sigurinë kibernetike



Shqipëria ka shënuar një arritje të rëndësishme në fushën e sigurisë kibernetike, duke u renditur në vendin e 15-të në botë sipas Indeksit Kombëtar të Sigurisë Kibernetike (NCSI). Në këtë kuadër, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, gjatë një vizite në Komandën Kibernetike dhe Ndërlidhjes, vlerësoi këtë rezultat si një dëshmi të përpjekjeve të pandërprera të Shqipërisë për të forcuar kapacitetet në sigurinë e informacionit, infrastrukturës dhe

mbrojtjes kibernetike.

“Ngjitja e Shqipërisë në vendin e 15-të në botë për sigurinë kibernetike është një arritje që na motivon të vazhdojmë me më shumë vendosmëri. Synimi ynë është që inovacioni të bëhet pjesë e ADN-së së çdo investimi modernizues në Forcat e Armatosura, duke garantuar mbrojtje efektive në të gjitha dimensionet – ushtarake dhe civile”, - deklaroi ministri Vengu.

Në përputhje me objektivat e strategjisë kombëtare “Mbrojtja 2030”, në Komandën Kibernetike dhe Ndërlidhjes u prezantua plani i rritjes së kapaciteteve, me fokus në trajnimin e specialistëve, përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe integrimin e inovacionit në sistemet e mbrojtjes. Ky rezultat i rëndësishëm reflekton angazhimin e qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Mbrojtjes për të ndërtuar një mjedis të sigurt digjital, që garanton mbrojtjen e interesave kombëtare dhe kontribuon në forcimin e sigurisë kolektive në kuadër të aleancave ndërkombëtare.





Gjenerallejtënant Arben Kingji vlerëson bashkëpunimin me FSK-në dhe përkushtimin për integrim rajonal



Në një takim me komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjenerallejtënant Bashkim Jashari, gjenerallejtënant Arben Kingji vlerësoi nivelin e lartë të bashkëpunimit mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Gjatë takimit u shpreh përkushtimi për forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, duke përfshirë finalizimin e pritshëm të një plani 3-vjeçar të përbashkët.

“Siç theksova edhe gjatë konferencës së përmbyllur dy ditë më parë, politika e dyerve të hapura mbetet parimi themelor i kësaj nisme. Anëtarësimi i Kosovës, i merituar dhe tashmë i vonuar, do të kontribuonte në stabilitetin rajonal”, - deklaroi gjenerallejtënant Kingji.

Ai përgëzoi progresin e FSK-së në fushën e modernizimit, zhvillimit dhe ndërveprueshmërisë, dhe ritheksoi mbështetjen e pakursyer të Shqipërisë për pjesëmarrjen e personelit të FSK-së në stërvitje, kurse dhe trajnime të përbashkëta me Aleancën. Gjenerallejtënant Kingji theksoi gjithashtu se Kosova mbetet një çështje parësore e interesit strategjik kombëtar për Shqipërinë, dhe si e tillë diskutohet në çdo takim, forum apo nismë rajonale ku përfaqësohet vendi.



Forcat e Armatosura të Shqipërisë thellojnë bashkëpunimin me NATO-n në fushën e standardizimit



Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë pritën për një vizitë zyrtare Drejtorin e Zyrës së Standardizimit të NATO-s (NSO), gjeneralmajor Thierry Poulette. Vizita e tij në Tiranë u zhvillua në kuadër të përpjekjeve për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe strukturave të Aleancës në fushën e standardizimit, si dhe për forcimin e rolit të vendit tonë në këtë proces të rëndësishëm për ndërveprueshmërinë ushtarake.

Gjatë qëndrimit në Shqipëri, gjeneralmajor Poulette zhvilloi një takim zyrtar me zëvendësministren e Mbrojtjes, znj. Bleri-

na Abrazhda. Në takim u diskutua mbi forcimin e kapaciteteve kombëtare në fushën e standardizimit, përfshirjen më aktive të ekspertëve shqiptarë në grupet e punës të NATO-s, si dhe nxitjen e shkëmbimeve teknike dhe profesionale me Zyrën e NATO-s për Standardizim.

Zëvendësministrja Abrazhda vlerësoi vizitën si një tregues konkret të bashkëpunimit të ngushtë mes palëve dhe theksoi rëndësinë që ka standardizimi në rritjen e efikasitetit, gatishmërisë dhe operacioneve të përbashkëta të Forcave të Armatosura të Shqipërisë me vendet aleate.

Në vijim të vizitës, në ambientet e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua një takim me komunitetin e standardizimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në aktivitet morën pjesë anëtarët e Bordit të Standardizimit, shefat e planifikimit, specialistët e fushës, personeli përgjegjës për ndjekjen e STANAG-eve sipas planit vjetor të ratifikimit për vitin 2025, si dhe kursantë të Kursit të Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm, të Kursit të Lartë të Oficerit dhe studentë të Akademisë së Forcave të Armatosura.

Gjatë këtij takimi, gjeneralmajor Poulette mbajti një leksion informues mbi rëndësinë e

standardizimit në NATO, duke theksuar proceset e zhvillimit dhe përditësimit të STANAG-eve, rëndësinë e përputhshmërisë së procedurave dhe pajisjeve ndërmjet vendeve aleate, si dhe sfidat aktuale me të cilat përballet Aleanca në këtë fushë. Ai vlerësoi përpjekjet dhe angazhimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë për përmbushjen e detyrimeve në fushën e standardizimit dhe inkurajoi vijimin e këtij procesi me profesionalizëm dhe përkushtim.

Gjithashtu, gjatë vizitës, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, priti në takim gjeneralmajor Poulette. Të dy palët diskutuan mbi nxitjen e proceseve të standardizimit dhe ndërveprueshmërisë, me qëllim që Forcat Aleate të veprojnë së bashku në mënyrë koherente dhe efektive për përmbushjen e objektivave taktike, operacionale dhe strategjike të Aleancës.

Vizita e gjeneralmajor Thierry Poulette në Shqipëri përbën një moment domethënës për rritjen e bashkëpunimit dhe përforcimin e lidhjeve me strukturat e NATO-s në fushën e standardizimit. Ajo shërben si nxitje për vijimin e përpjekjeve në përmirësimin e kapaciteteve vendore dhe integrimin e plotë të Forcave të Armatosura të Shqipërisë në proceset teknike dhe operative të Aleancës.



Qendra e Personel Rekrutimit hap dyert me pamje të re dhe kushte moderne pune



Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletënant Arben Kingji, vizitoi godinën e rindërtuar të Qendrës së Personel Rekrutimit (QPR), e cila tashmë ofron kushte bashkëkohore dhe funksionale për zhvillimin e aktivitetit të përditshëm.

Punimet, të realizuara në më pak se një vit, kanë



përfshirë një sipërfaqe prej 3.700 metrash katrorë dhe kanë sjellë përmirësime thelbësore në të gjitha ambientet. Projekti ka pasur si synim modernizimin e infrastrukturës, përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve që u ofrohen si personelit të Forcave të Armatosura, ashtu edhe qytetarëve.

Qendra e Personel Rekrutimit ofron sot edhe shërbime digjitale përmes Zyrës së Shërbimeve Online, ku vetëm gjatë muajit të fundit janë ofruar mbi 4000 shërbime në 7 kategori të ndryshme, të dedikuara për ushtarakët aktivë, ish-ushtarakët, civilët dhe qytetarët që kanë kryer shërbimin ushtarak.

Gjatë vizitës, ministri Vengu vlerësoi punën e kryer dhe theksoi rëndësinë e krijimit të kushteve dinjitoze për personelin ushtarak: “Më vjen mirë që jeni tashmë në kushte të rehabilituara, sepse një nga detyrat kryesore

është përkujdesja për ecurinë e karrierës. Duhet të vijojmë me digjitalizimin e proceseve në mënyrë që rekrutimet, trajnimet dhe certifikimet të kryhen sa më transparente dhe thjeshtë”, – u shpreh ministri Vengu.

Ai shtoi se digjitalizimi dhe meritokracia janë në qendër të reformës që po zbatohet në sistemin e Mbrojtjes:

“Me kushte më cilësore dhe me automatizimin e një pjese të proceseve, do të rrisim perceptimin dhe bindjen se në këtë strukturë ekziston meritokracia dhe secilit i jepet e drejta që meriton”, – theksoi ministri.

Ky investim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt modernizimit të Forcave të Armatosura, duke forcuar angazhimin e Qendrës së Personel Rekrutimit për të ofruar shërbime më cilësore, më transparente dhe në përputhje me standardet bashkëkohore të mbrojtjes kombëtare.



Inovacioni në qendër të vizionit të Ministrisë së Mbrojtjes: Ministri Vengu në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Ministri Pirro Vengu:
Inovacioni është në
qendër të vizionit tonë
për transformimin e
gjithë konstelacionit
të Mbrojtjes në një
mekanizëm inteligjent
dhe promotor të
modernizimit

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, zhvilloi një vizitë në Qendrën e Inovacionit të Sigurisë dhe Mbrojtjes (QISM), ku u diskutua mbi hapat e ardhshëm në kuadër të strategjisë kombëtare “Mbrojtja 2030”.

Gjatë takimit me punonjës dhe ekspertë të QISM, ministri Vengu theksoi rëndësinë e aplikimit të Inteligjencës Artificiale si një instrument thelbësor për sintetizimin e informacionit, rritjen e efikasitetit operacional dhe zhvillimin teknologjik të Forcave të Armatosura në çdo nivel.

Në fokus të diskutimeve ishte gjithashtu mbështetja e industrisë së mbrojtjes përmes teknologjive inteligjente dhe zgjidhjeve inovative, të cilat do të mundësojnë krijimin e një strukture më moderne dhe të aftë për t'u përshtatur me sfidat e reja të sigurisë.

“Inovacioni është në qendër të vizionit tonë për transformimin e gjithë konstelacionit të Mbrojtjes në një mekanizëm inteligjent dhe promotor të modernizimit”, – u shpreh ministri Pirro Vengu, duke theksuar angazhimin

e Ministrisë për të ecur drejt një epoke të re teknologjike në sistemin e mbrojtjes.

Në takim u nënvizua përkushtimi i Ministrisë së Mbrojtjes për të avancuar teknologjitë moderne, për të forcuar kapacitetet kërkimore dhe inovative, si dhe për të ndërtuar një sistem mbrojtjeje të qëndrueshëm, efikas dhe të përgatitur për sfidat e së ardhmes.

Kjo nismë vjen si pjesë e procesit të modernizimit të strukturave të Forcave të Armatosura, në përputhje me objektivat e strategjisë “Mbrojtja 2030”, që synon ndërtimin e një infrastrukture mbrojtjeje të bazuar në teknologji të zgjuar, analiza të avancuara të të dhënave dhe zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.



Uells, Mbretëria e Bashkuar, 16 tetor 2025: Sukses i jashtëzakonshëm i Forcave të Armatosura në garën ndërkombëtare “Cambrian Patrol”



Efektivat e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut kanë përfaqësuar me dinjitet dhe profesionalizëm Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë në garën më sfiduese ushtarake ndërkombëtare, “Cambrian Patrol”, e zhvilluar në Uells, Mbretëria e Bashkuar, duke u renditur në vendin e 3-të mes 122 ekipeve pjesëmarrëse nga 32 vende të botës.

Pas javësh përgatitjeje intensive, ushtarakët shqiptarë dëshmuar aftësi të jashtëzakonshme fizike, taktike dhe psikologjike, duke përballuar me sukses 48 orë patrullimi në një distancë prej 60 kilometrash, në terren të vështirë dhe me ngarkesë mbi 32 kilogramë secili.

Gjatë gjithë garës, ekipi shqiptar shfaqti vendosmëri, disiplinë dhe profesionalizëm të lartë, duke fituar vlerësime të posaçme nga organizatorët dhe ekipet e tjera pjesëmarrëse. Ky rezultat i lartë rendit Shqipërinë ndër vendet më të suksesshme të këtij edicioni dhe është një dëshmi e përgatitjes, përkushtimit dhe nivelit të lartë të standardeve të trajnimit në Forcat e Armatosura.

Suksesi në “Cambrian Patrol” përbën një arritje të rëndësishme për ushtrinë shqiptare, e cila me performancën e saj të shkëlqyer konfirmon aftësinë për të konkurruar denjësisht në arenën ndërkombëtare ushtarake, duke mbajtur lart me krenari flamurin kombëtar.

Tradita e humanizmit në uniformë: Forca Tokësore në mbështetje të fëmijëve talasemikë

*Ushtarakët e Batalionit të Tretë të Këmbësorisë në Korçë
dhurojnë gjak për fëmijët talasemikë dhe personat në nevojë*



Në kuadër të nismës humanitare “Dhuroni gjak, shpëtoni jetë!”, ushtarakët e Batalionit të Tretë të Këmbësorisë, pjesë e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut në Forcën Tokësore, vijuan traditën e dhurimit vullnetar të gjakut për fëmijët talasemikë dhe personat në nevojë.

Pas një fushate sensibilizuese të zhvilluar nga personeli mjekësor i Degës së Shëndetësisë dhe Degës së BCU-së, në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, 27 ushtarakë iu bashkuan kësaj nisme humane, duke dhënë shembull të përkushtimit dhe humanizmit që karakterizon trupën ushtarake shqiptare.

Ky aktivitet vlerësohet si një akt solidariteti dhe përgjegjësie qytetare, që tregon se shërbimi ndaj jetës dhe komunitetit është pjesë e pandarë e misionit të çdo ushtaraku.

Faleminderit të gjithë atyre që kontribuojnë me gjestin më fisnik, dhurimin e gjakut për të shpëtuar jetë!



BMEC shënon 38-vjetorin e krijimit, ministri Vengu vlerëson kontributin e saj në mbrojtjen dhe sigurinë e qytetarëve shqiptarë



Baza e Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC) shënoi më 1 shtator të vitit 2025, 38-vjetorin e krijimit të saj në një ceremoni të veçantë, ku morën pjesë përfaqësues të lartë të politikës ushtarake dhe efektive të kësaj strukture të Forcave të Armatosura.

Në fjalën e tij përshëndetëse, ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, vlerësoi kontributin e jashtëzakonshëm të BMEC në shërbim të sigurisë dhe mbrojtjes së qytetarëve shqiptarë.

Ministri Vengu theksoi se, gjatë këtyre dekadave BMEC ka qenë gjithmonë në vijën e parë të përballjes me fatkeqësitë natyrore dhe situatat emergjente, duke treguar gatishmëri dhe vendosmëri pa kushte. “Sot shënojmë 38 vite mision dhe besnikëri ndaj Shqipërisë. Ju keni treguar se misioni juaj nuk ka sezon. Në dimër e



në verë, ditën e natën, BMEC është gjithmonë aty: për të shpëtuar jetë, për të mbrojtur pasuri, për të garantuar siguri”, - tha ministri Vengu.

Ai nënvizoi rolin e rëndësishëm të kësaj force në reagimin ndaj emergjencave, duke theksuar se ajo është një forcë që nuk dorëzohet, nuk heziton dhe nuk tërhiqet.

Gjithashtu, ministri theksoi rëndësinë e trajnimit të skuadrave vendore për të siguruar një reagim më të shpejtë në çdo cep të vendit.

“Ju nuk jeni vetëm një forcë e gatshme, ju jeni edhe shumëzues force për gjithë vendin. Sot BMEC është më e fortë, më e trajnuar dhe më e pajisur se kurrë. Investimet që kemi bërë janë garanci që forca juaj do të rritet çdo vit. Por mbi të gjitha, është karakteri dhe disiplina juaj që e bëjnë këtë bazë të pathyeshme”, - përfundoi ministri Vengu.

Në aktivitet ishin të pranishëm gjeneralë, oficerë, nënoficerë dhe punonjës të BMEC, të cilët u falënderuan për kontributin e tyre të përditshëm në mbrojtje të jetës dhe sigurisë së qytetarëve shqiptarë.





Shqipëria riafirmon angazhimin në Aleancë: Zëvendësministria Abrazhda në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s



Zëvendësministria e Mbrojtjes, znj. Blerina Abrazhda, mori pjesë në Ministerialin e Ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, që u zhvillua në Bruksel, ku u diskutua mbi sfidat aktuale të sigurisë, përparësitë strategjike të Aleancës dhe hapat për zbatimin e vendimeve të Samitit të Hagës.

Në fjalën e saj para ministrave të mbrojtjes të vendeve aleate, znj. Abrazhda vuri në dukje angazhimin e Shqipërisë për avancimin e prioritetëve kombëtare të mbrojtjes, në përputhje me objektivat e NATO-s dhe strategjinë e përbashkët të sigurisë.

“Jemi në një trajektore të qëndrueshme rritjeje të shpenzimeve të mbrojtjes dhe modernizimit cilësor, të shoqëruar me zhvillimin e kapaciteteve të montimit dhe integritit në zinxhirët e furnizimit të aleatëve, shtimin e aftësive mbrojtëse dhe reaguese, si dhe investime në qëndrueshmërinë kombëtare, përfshirë infrastrukturën kritike”, – u shpreh zëvendësministria Blerina Abrazhda. Ajo nënvizoi se Shqipëria po vijon të kontribuojë në mënyrë aktive në misionet dhe operacionet e Aleancës, duke forcuar rolin e saj si një partner i besueshëm dhe i përkushtuar ndaj paqes dhe sigurisë kolektive. Në përfundim të fjalës së saj, znj. Abrazhda përsëriti thirrjen për më shumë vëmendje politike dhe prezencë ushtarake të NATO-s në Ballkanin Perëndimor, me qëllim dekurajimin e rreziqeve të sigurisë në Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë. Ajo theksoi gjithashtu nevojën që çështja e integritit të Kosovës në NATO të rikthehet në tryezën e diskutimeve, duke e konsideruar këtë si një hap thelbësor për sigurinë dhe stabilitetin e qëndrueshëm të rajonit.

“Shqipëria mirëpret rritjen e rolit dhe angazhimit të NATO-s në strukturimin e marrëdhënieve me Kosovën, aspirata e së cilës mbetet integritimi euroatlantik”, – përfundoi znj. Abrazhda.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë ministerial riafirmon angazhimin e vendit tonë ndaj parimeve të Aleancës, forcimin e kohezionit ndërmjet aleatëve, si dhe kontributin aktiv për një hapësirë euroatlantike më të sigurt dhe më të qëndrueshme.

Gjenerallejtënant Arben Kingji në Takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s në Riga: Shqipëria, e angazhuar për modernizimin dhe sigurinë rajonale



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjenerallejtënant Arben Kingji mori pjesë në takimin e radhës të Komitetit Ushtarak të NATO-s në nivel Shefash Shtabi, i zhvilluar në Riga të Letonisë.

Takimi i Komitetit Ushtarak, që përbën forumin konsultativ dhe vendimmarrës të nivelit më të lartë ushtarak në Aleancë, u fokusua në situatat aktuale të sigurisë, sfidat e reja me të cilat përballlet NATO, si dhe në mbështetjen e proceseve të transformimit dhe modernizimit të saj.

Në diskutimet e mbajtura, u vu theksi te eksperimentimi dhe inovacioni si instrumente thelbësore për të ruajtur avantazhin strategjik të Aleancës dhe superioritetin e instrumentit ushtarak të fuqisë. Gjithashtu, u rikonfirmua vullneti i vendeve anëtare për të përmbushur objektivat e kapaciteteve dhe për të garantuar mbrojtjen e integritetit të zonës euroatlantike, ndaj çdo kërcënimi të mundshëm, në një qasje gjithëpërfshirëse prej 360 gradësh.

Një pjesë e rëndësishme e diskutimeve iu kushtua Ballkanit Perëndimor, i cili u theksua si një rajon me rëndësi strategjike për Aleancën. U nënvizua mbështetja për misionin e KFOR-it në Kosovë, si një element kyç për sigurinë dhe stabilitetin rajonal.

Në fjalën e tij, gjenerallejtënant Arben Kingji konfirmoi angazhimin e Shqipërisë për të vijuar rrugën e modernizimit dhe zhvillimit të Forcave të Armatosura, si dhe për të kontribuar në planet rajonale të Aleancës, duke ruajtur një qasje aktive dhe të besueshme në misionet dhe operacionet e NATO-s.

“Shqipëria është plotësisht e përkushtuar ndaj objektivave të NATO-s. Modernizimi i Forcave të Armatosura, pjesëmarrja jonë në misione dhe operacione të Aleancës, si dhe qasja jonë proaktive për bashkëpunim dhe stabilitet rajonal, mbeten pjesë e pandashme e angazhimit tonë strategjik”, – theksoi Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH.

Pjesëmarrja e Shqipërisë në këtë forum të nivelit më të lartë konfirmon rolin aktiv të vendit tonë në proceset e sigurisë kolektive dhe përforcon angazhimin e saj për të qenë një partner i besueshëm në arkitekturën e sigurisë euroatlantike.



Presidenti Begaj dhe SHSHPFA, gjenerallejtënant Arben Kingji, pritën gjeneralmajor Ulutaş për sigurinë në Ballkan



Presidenti Begajaj prit Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş, në vizitë zyrtare në Shqipëri

Presidenti i Republikës, Sh. T. z. Bajram Begaj, prit në një takim zyrtar Komandantin e Misionit të NATO-s në Kosovë (KFOR), gjeneralmajor Özkan Ulutaş. Kreu i Shtetit shprehu vlerësimin për marrjen e mandatit të dytë të Komandantit të KFOR-it nga Turqia dhe mirënjohjen për angazhimin e trupave të saj në misionin e paqes në Kosovë.

Gjatë bisedës u theksua rëndësia e misionit për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit jo vetëm në Kosovë, por edhe në rajon, si dhe nevoja për bashkëpunim të ngushtë mes KFOR-it dhe institucioneve të Kosovës, veçanërisht me Forcën e Sigurisë së Kosovës, për zhvillimin, modernizimin dhe transformimin e saj sipas standardeve të NATO-s. Presidenti Begaj rikofirmoi mbështetjen e Shqipërisë ndaj misionit dhe nënvizoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit rajonal për paqe dhe siguri.

Në vazhdim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji, prit gjithashtu gjeneralmajor Ulutaş. Gjatë takimit u diskutua situata e përgjithshme e sigurisë, sfidat dhe kërcënimet në Ballkanin Perëndimor, si dhe roli i vazhdueshëm i misionit KFOR për stabilitetin rajonal. Gjenerallejtënant Kingji konfirmoi angazhimin e Forcave të Armatosura të Shqipërisë për mbështetje të vazhdueshme të KFOR-it.

Komandanti i KFOR-it, gjeneralmajor Ulutaş, falënderoi për pritjen e ngrohtë dhe vlerësoi profesionalizmin dhe kontributin e trupave shqiptare në kuadër të misionit. Në përfundim të takimeve, të dy autoritetet vlerësuan përpjekjet e përbashkëta për përmirësimin e sigurisë në Kosovë dhe rajon.



SHSHPFA gjenerallejtënant Arben Kingji prit Komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Özkan Ulutaş



Gjenerallejtënant Arben Kingji në Ekspozitën Ndërkombëtare të Industrisë së Mbrojtjes në Slloveni

Siguria rajonale në fokus: Pjesëmarrja e Shqipërisë në Ekspozitën Ndërkombëtare të Mbrojtjes

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, me ftesë të homologut slloven, gjenerallejtënant Robert Glavaš, mori pjesë në Ekspozitën Ndërkombëtare të Industrisë së Mbrojtjes, ku u prezantuan produktet më të fundit në fushën e mbrojtjes.

Gjatë aktivitetit u theksua rëndësia e inovacionit dhe bashkëpunimit ndërkombëtar për adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë, si dhe mundësitë për shkëmbim të njohurive teknike dhe eksperiencës midis forcave dhe industrive mbrojtëse të vendeve pjesëmarrëse.

Gjenerallejtënant Kingji shfrytëzoi rastin për të vlerësuar kontributin e kompanive dhe institucioneve pjesëmarrëse në avancimin e kapaciteteve të mbrojtjes, duke nënvizuar rolin e bashkëpunimit në fuqizimin e sigurisë rajonale dhe kombëtare.



SHSHPFA, gjeneralletenant Arben Kingji: Uniteti, garancia më e fortë për paqe e stabilitet në Ballkanin Perëndimor



Në Tiranë u zhvillua Konferenca e 28-të e Shefave të Shtabit të Forcave të Armatosura të nismës SHBA-Karta e Adriatikut (A-5), një forum i rëndësishëm për sigurinë rajonale.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralletenant Arben Kingji, në fjalën e tij theksoi rëndësinë e këtij bashkëpunimi shumëpalësh, duke vënë në dukje se uniteti është çelësi i paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë.

“Jam i nderuar që bashkë-kryesova këtë konferencë

me komandantin e Komandës Amerikane për Evropën dhe Komandës Supreme Aleate, gjeneral Alexis Grynkeuich, dhe me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Bosnjë-Hercegovinës, gjeneral Gojko Knežević, – u shpreh gjenerallejtënant Kingji.

Ai nënvizoi se Karta e Adriatikut mbetet një instrument i veçantë për forcimin e marrëdhënieve mes vendeve të rajonit, sidomos në kushtet aktuale kur sfidat e sigurisë janë në rritje.

“Kjo nismë mbetet një platformë e veçantë për forcimin e bashkëpunimit rajonal, në këtë kohë sfidash të sigurisë, ku uniteti ynë është garancia më e fortë për paqe dhe stabilitet në Ballkanin Perëndimor”, - deklaroi ai.

Në vijim, shefi i Shtabit të Përgjithshëm siguroi përfaqësuesit e vendeve pjesëmarrëse se Shqipëria është dhe do të mbetet e angazhuar në objektivat e përbashkëta të kësaj nisme.

“Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar ndaj objektivave të Kartës së Adriatikut, duke punuar krah për krah me aleatët dhe partnerët tanë për një të ardhme më të sigurt dhe më të begatë për popujt tanë”, – theksoi gjenerallejtënant Kingji.

Konferenca e Kartës së Adriatikut shërben si një mekanizëm bashkëpunimi dhe koordinimi mes vendeve të rajonit dhe Shteteve të Bashkuara, me synim forcimin e sigurisë dhe stabilitetit në Evropën Juglindore.

Ndërsa në fjalën e tij të rastit Komandanti i Komandës Europiane të Shteteve të Bashkuara (EUCOM) dhe Komandant Suprem i Forcave Aleate për Evropën (SACEUR), gjeneral Grynkeuich vlerësoi udhëheqjen e vendeve të rajonit dhe riafirmoi mbështetjen e SHBA-së për sigurinë dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor dhe mirënjohje për mikpritjen dhe udhëheqjen rajonale.

Gjenerali Grynkeuich falënderoi Shqipërinë dhe Bosnjë-Hercegovinën për mikpritjen dhe kontributin e tyre në organizimin e aktivitetit.

“Një qytet shumë i bukur! Vendet tuaja kanë treguar udhëheqje të vërtetë dhe një angazhim të jashtëzakonshëm për sigurinë dhe stabilitetin nga të cilët të gjithë ne përfitojmë”, – u shpreh ai.

Në fjalën e tij, gjenerali Grynkeuich theksoi rolin e pazëvendësueshëm të Kartës së Adriatikut si platformë për dialog strategjik dhe bashkëpunim praktik midis vendeve anëtare: Shqipërisë, Bosnjë-Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë

së Veriut si dhe dy vendeve vëzhguese, Kosovës dhe Sllovenisë.

“Është thelbësore që të takohemi rregullisht për të forcuar bashkëpunimin tonë. SHBA-Karta e Adriatikut mbetet një forum i pazëvendësueshëm për një Europë të lirë, të sigurt dhe të begatë”, – theksoi ai.

Gjenerali kujtoi nënshkrimin e Deklaratës së Përbashkët, duke e cilësuar si një akt që riafirmon vizionin e përbashkët për stabilitetin dhe sigurinë euro-atlantike: “Ishte një nder të përfaqësoja Shtetet e Bashkuara në këtë nënshkrim që thekson rëndësinë e koordinimit të ngushtë për sigurinë rajonale”.

Në mesazhin e tij, Komandanti i NATO-s për Evropën theksoi nevojën që rritja e shpenzimeve për mbrojtjen të shndërrohet në aftësi të prekshme ushtarake përmes modernizimit dhe bashkëpunimit të ngushtë.

“Duhet të përqendrohemi në përmirësimin e ndërveprueshmërisë, ndërtimin e gatishmërisë dhe zhvillimin e marrëveshjeve mbështetëse. Pas diskutimeve optimiste të sotme, jam i bindur se mund t'i arrijmë këto qëllime.”

Gjenerali Grynkeuich vlerësoi programin e punës së grupit të implementimit për vitin e ardhshëm dhe u shpreh i bindur se sfidat mund të përballohen përmes solidaritetit.

“Teksa ecni përpara, dijeni se nuk jeni vetëm. Së bashku me kolegët dhe aleatët e Kartës së Adriatikut, ne do të përqafojmë një të ardhme të sigurt, të qëndrueshme dhe të begatë”.



Gjenerallejtënant Arben Kingji: Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë është zemra e mendimit strategjik kombëtar



Hapet viti i ri akademik 2025-2026

Në një ceremoni solemne, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në hapjen e kurseve institucionale në Kolegjin e Mbrojtjes dhe Sigurisë (KMS) për vitin e ri akademik 2025-2026.

Të pranishëm në këtë aktivitet ishin komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade



Bardhyl Nuredinaj, zëvendëskomandanti i Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Arben Toska, përfaqësues të Shtabit të Përgjithshëm, pedagogë, trajnues dhe drejtues të departamenteve.

Në përshëndetjen e tij, gjenerallejtënant Kingji e konsideroi këtë ditë një moment të veçantë për jetën akademike ushtarake, duke theksuar se Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë përbën qendrën e formimit strategjik kombëtar.

“Kolegji është zemra e mendimit strategjik kombëtar. Këtu ngrihen shtyllat e kualifikimit të avancuar profesional, përgatiten drejtuesit që do të marrin vendime vendimtare për fatet e vendit, formohet elita ushtarake dhe civile e Shqipërisë. Edukimi dhe kualifikimi i personelit ushtarak dhe civil në nivelet më të larta të drejtimit, për përdorimin efikas të fuqisë kombëtare në paqe, krizë apo luftë, dhe formimi i liderëve do të shërbejnë në partneritete rajonale dhe në Aleancën e NATO-s”, – u shpreh Kingji. Ai vuri theksin në riorientimin dhe riorganizimin e sotëm akademik, që synon të krijojë një sistem të integruar e koherent, ku ndërthuren kurrikulat e përditësuara, simulimet konstruktive virtuale, kërkimi shkencor ushtarak dhe trajnimi i trupave. Gjenerallejtënant Kingji paraqiti vizionin e tij për një zinxhir të plotë përgatitjeje: Akademia e Forcave të Armatosura, ku formohet lideri i ri; Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, ku aftësohen drejtuesit në nivelet operacionale dhe strategjike; Akademia e Nënoficerëve, ku konsolidohet profesionalizmi teknik; Shkollat e Trupës, ku ngrihet baza e disiplinës dhe aftësive ushtarake.

Ai theksoi gjithashtu rëndësinë e përditësimit

të programeve mësimore, futjen e digjitalizimit në kurrikula, ngritjen e cilësisë së mësimdhënies përmes shkëmbimeve profesionale, si dhe përdorimin në shkallë të plotë të Qendrës së Simulimit.

“Ky është misioni ynë i përbashkët dhe garancia më e fortë për të ardhmen e Forcave të Armatosura, vendit dhe sigurisë kolektive. Nga ky Kolegj do të dalin burrat dhe gratë që do të mbrojnë Shqipërinë, do të udhëheqin operacionet ndërkombëtare dhe do të sigurojnë që vendi ynë të mbetet një partner i besueshëm i sigurisë së përbashkët euroatlantike”, – u shpreh Shefi i Shtabit të Përgjithshëm.

Programe dhe pjesëmarrësit e këtij viti akademik

Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë nis vitin akademik 2025-2026 me dy programe kryesore: Kursi i Komandës dhe Shtabit të Përgjithshëm (KKSH) dhe Kursi i Lartë i Oficerit (KLO). Në këto programe do të vijnë studimet 83 kursantë, prej të cilëve 76 nga FARSH dhe 7 nga Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK), duke reflektuar bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve.

Po ashtu, Kolegji po përgatit hapjen në mars 2026 të Kursit të Lartë për Sigurinë dhe Mbrojtjen (KLSM-16), kursi më i lartë në piramidën e arsimit ushtarak në vend, me pjesëmarrje gjithnjë në rritje nga vendet e rajonit, NATO dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë.

Kjo qasje e re akademike e vendos KMS-në si një qendër referimi për formimin e elitës ushtarake dhe civile, duke përforcuar rolin e Shqipërisë në arkitekturën e sigurisë rajonale dhe euroatlantike.





Stërvitje e përbashkët detare mes Anijes “Lissus” dhe “RUEGEN” në Detin Egje



Efektivi i Anijes patrulluese “Lissus” P-133, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen flamurtare gjermane “RUEGEN” A-1453, në kuadër të misionit të NATO-s në Detin Egje. Gjatë aktivitetit, u ushtruan disa skenarë të planifikuar stërvitor, përfshirë komunikimin përmes flamujve sinjalizues dhe manovrën detare “Sailing Pass”. Qëllimi i stërvitjes ishte rritja e ndërveprimit ndërmjet ekuipazheve, forcimi i bashkëpunimit dypalësh në det, si dhe përmirësimi i aftësive për kryerjen e operacioneve të përbashkëta detare. Kjo aktivitet konfirmon angazhimin e Forcës Detare në përmbushjen e standardeve të Aleancës dhe forcimin e kapaciteteve ndërvepruese në operacionet detare.



Tre anije italiane vizitojnë ujërat territoriale shqiptare



Tre anije të Forcës Detare italiane vizituan ujërat territoriale shqiptare, në kuadër të stërvitjeve dhe trajnimeve të përbashkëta me Forcat Detare të Shqipërisë.

Nënadmiral Adnand Agastra, Komandant i Forcës Detare / Rojës Bregdetare, zhvilloi një vizitë zyrtare në bordin e anijes SPICA, ku u prit nga Kundëradmirali Davide De Pozzo dhe Komandanti i anijes SPICA.

Gjatë takimit u diskutua mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet forcave detare të dy vendeve dhe mbi çështjet e sigurisë rajonale detare. Po ashtu, u zhvillua një përshëndetje përmes video-transmetimit (VTC) me Komandantin e Flotës italiane, Nënadmiralin Aurelio De Carolis. Ky aktivitet i përbashkët synon forcimin e bashkëpunimit operacional të Forcave Detare të Shqipërisë dhe Italisë.

Anija SPICA është e klasit CASSIOPEA, ndërsa anija simotër LIBRA pritët të bashkohet së shpejti flotës së Forcës Detare Shqiptare, duke shtuar kapacitetet operative të saj.

“SEA THE FUTURE”

**HORIZONT BLU:
FORCA DETARE, SHTYLLA
E SIGURISË DHE E SË ARDHMES
DETARE TË SHQIPËRISË**



Më 25 shtator 2025, në kuadër të Ditës së Detarisë, Porti i Durrësit u bë qendra e një aktiviteti të rëndësishëm me titullin “Horizont Blu: Sfida dhe Mundësitë e Detarisë”, ku u diskutua roli i Forcës Detare në sigurinë kombëtare, bashkëpunimi me partnerët civilë e ndërkombëtarë dhe perspektiva që ofron kjo forcë për të rinjtë. Në panel mori pjesë edhe nënkolonel Leti Sulaj, shefe e Degës së BCU-së në Komandën e Forcës Detare, e cila ndau një fjalë të plotë e të strukturuar, duke u ndalur në tri pika kryesore: siguria kombëtare, partneritetet dhe mesazhi për të rinjtë.

Forca Detare, garanci e sigurisë kombëtare dhe detare

Sipas N/kolonel Sulajt, Forca Detare e Republikës së Shqipërisë është shtylla kryesore e mbrojtjes së sovranitetit në det. Hapësira detare shqiptare është një pasuri strategjike e lidhur ngushtë me sigurinë kombëtare, ekonominë dhe integrimin euroatlantik. Me patrullime të përditshme, monitorim të hapësirës detare dhe operacione kërkim-shpëtimi, Forca Detare jo vetëm që mbron kufijtë dhe jetën njerëzore në det, por kontribuon edhe në luftën kundër kontrabandës, trafikimit dhe ndotjes mjedisore. Sot, Shqipëria është një aktor aktiv në misionet e NATO-s në Egje e Mesdhe, duke forcuar rolin e saj në sigurinë kolektive dhe duke rritur prestigjin ndërkombëtar.

Bashkëpunimi me institucionet civile dhe partnerët ndërkombëtarë

“Siguria detare është një detyrë e përbashkët”, theksoi Sulaj. Forca Detare bashkëpunon ngushtë me Policinë Kufitare, Autoritetet Portuale, Agjencitë e Emergjencave Civile dhe institucione akademike e mjedisore, duke mbrojtur jo vetëm kufijtë, por edhe pasuritë natyrore detare.

Në planin ndërkombëtar, partneriteti me flotat e vendeve aleate dhe partnere është thelbësor. Stërvitjet e përbashkëta, shkëmbimi i eksperiencave dhe misionet shumëkombëshe e bëjnë Forcën Detare një partner të besueshëm në Mesdhe, duke garantuar siguri jo vetëm për Shqipërinë, por edhe për rajonin dhe më gjerë.

Mesazhi për të rinjtë, karriera në Forcën Detare

Një pjesë e veçantë e fjalës së saj iu kushtua brezit të ri. Forca Detare, sipas N/kolonel Sulajt, është një karrierë e ndershme dhe fisnike, që u jep të rinjve mundësinë për arsimim të specializuar, trajnime brenda e jashtë vendit, zhvillim profesional dhe lidhesh në një mjedis disipline, teknologjie dhe partneritetesh ndërkombëtare. “Shërbimi në Forcën Detare nuk është vetëm një profesion, por një mision fisnik. Në det mbrohet jo vetëm kufiri ynë, por edhe siguria e qytetarëve, ekonomia kombëtare dhe e ardhmja e vendit”, u shpreh Sulaj, duke i ftuar të rinjtë të jenë pjesë e këtij misioni të madh. Paneli “Horizont Blu” shërbeu si një dëshmi e qartë e rolit të Forcës Detare si garant i sigurisë kombëtare dhe si një forcë moderne në transformim të vazhdueshëm. Me bashkëpunimin ndërinstitutional dhe ndërkombëtar, si dhe me hapjen e dyerve për të rinjtë, Forca Detare mbetet një aktor i pazëvendësueshëm për sigurinë dhe të ardhmen e Shqipërisë në hapësirën detare.

Stërvitje e përbashkët midis Regjimentit të Operacioneve Speciale dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, për përdorimin e mjeteve ajrore pa pilot



Në Regjimentin e Operacioneve Speciale ka nisur stërvitja e përbashkët me efektivat e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e fokusuar në përdorimin dhe menaxhimin e mjeteve ajrore pa pilot (UAV). Qëllimi i kësaj stërvitjeje është forcimi i bashkëpunimit mes dy forcave, rritja e ndërveprimit operacional dhe zhvillimi i mëtejshëm i aftësive teknike dhe taktike në përdorimin e sistemeve të avancuara ajrore.

Gjatë kësaj stërvitjeje, pjesëmarrësit po shkëmbejnë përvoja dhe praktika të mira në fushën e zbulimit, vëzhgimit dhe mbështetjes së operacioneve nga ajri, duke theksuar rëndësinë e teknologjisë moderne në përmirësimin e efikasitetit të misioneve.

Ky aktivitet është pjesë e programit të bashkëpunimit dypalësh ndërmjet Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, i cili synon rritjen e kapaciteteve të përbashkëta në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe forcimin e partneritetit strategjik mes dy institucioneve.

“Strong Eagle-10”, stërvitje e përbashkët e Forcave Speciale shqiptare dhe britanike

Regjimenti i Operacioneve Speciale zhvilloi stërvitjen e radhës “Strong Eagle-10”, në bashkëpunim me njësinë homologe të Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar. Aktiviteti kishte në fokus përgatitjen e strukturës SOLTG për vlerësimin SOFEVAL të NATO-s, që do të zhvillohet vitin e ardhshëm, si pjesë e procesit të integritetit të plotë të kapaciteteve tona në Aleancë.

Kjo stërvitje përbën një hap të rëndësishëm në rritjen e profesionalizmit dhe ndërveprueshmërisë së trupave tona speciale me partnerët ndërkombëtarë, duke forcuar gatishmërinë për të operuar në misionet e ardhshme të përbashkëta.

Efektivët shqiptarë marrin pjesë në garën prestigjioze “Cambrian Patrol 25” në Uells



Efektivët e Regjimentit të Këmbësorisë së Jugut marrën pjesë në garën ndërkombëtare “Cambrian Patrol 25”, e cila u zhvillua në Uells dhe njihet si një nga sfidat më prestigjioze dhe më të vështira ushtarake në nivel botëror.

“Cambrian Patrol” organizohet nga Shtabi i Brigadës së 160-të uellsiane në emër të Komandantit të Ushtrisë Tokësore britanike. Kjo garë ka një traditë mbi 60-vjeçare dhe është shndërruar në aktivitetin kryesor të patrullës ushtarake me të gjitha armët. Ajo është e hapur jo vetëm për forcat e armatosura britanike (të rregullta dhe rezerviste), por edhe për pjesëmarrës nga ushtritë e vendeve aleate dhe partnere, të cilat inkurajohen fuqimisht të marrin pjesë.

Ndryshe nga një konkurs klasik, “Cambrian Patrol” është një ushtrim i bazuar në skenarë misioni, ku performanca e patrullës vlerësohet në vazhdimësi mbi bazën e programit mësimor të mjeteve të betejës, kërkesave individuale të trajnimit, qëndrueshmërisë dhe aftësive të lidërshipt.

Gara përbëhet nga tetë faza, secila me një kohëzgjatje prej 48 orësh, duke u shtrirë në një periudhë 10-ditore. Gjatë saj, çdo patrullë mbulon rreth 60 km terren të thyer me ngjitje e zbritje mesatare mbi 1000 metra, duke mbajtur deri në 32 kg pajisje për person.

Për shkak të intensitetit, kjo garë kërkon përgatitje të lartë mendore dhe fizike, duke testuar në maksimum qëndrueshmërinë, vendosmërinë dhe bashkëpunimin e çdo ekipi.

Pjesëmarrja e efektivëve shqiptarë në “Cambrian Patrol 25” përbën një mundësi të rëndësishme për të forcuar aftësitë profesionale, për të shkëmbyer përvoja me ushtri partnere dhe për të rritur prezencën e Forcave të Armatosura të Shqipërisë në skenën ndërkombëtare.

ANALIZË

Mendimi *kritik*,
arma e heshtur e
USHTARAKUT MODERN

**ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve**

**GUXONI TË MENDONI NDRYSHE, FORCA E RINISË NË
UNIFORMË**

Mos e konsideroni veten tepër të rinj dhe të paformuar për të shprehur dyshime, për të hapur diskutime, kur mendoni ndryshe!

Në çdo formacion ushtarak, në çdo repart apo akademi, ekziston një parim i pathyeshëm: disiplina dhe respekti ndaj hierarkisë. Këto janë themelet mbi të cilat ngrihet çdo ushtri profesionale dhe efektive. Por krahas disiplinës, ushtria moderne kërkon edhe mendim kritik, reflektim, dhe guxim intelektual.

Në këtë kuptim, shprehja “Mos e konsideroni veten tepër të rinj dhe të paformuar për të shprehur dyshime, për të hapur diskutime, kur mendoni ndryshe”, nuk është thjesht një këshillë morale, por një thirrje për zhvillim personal e profesional të çdo efektiv të Forcave të Armatosura.

RINIA USHTARAKE DHE FORCA E MENDIMIT

Shpesh, të rinjtë që hyjnë në radhët e ushtrisë ndihen të inferiorë përballë përvojës së oficerëve të lartë apo komandantëve. Ata mund të mendojnë se nuk kanë mjaftueshëm dije për të ngritur pyetje, për të dhënë mendim, apo për të hapur një diskutim profesional. Por realiteti është ndryshe.

Çdo brez i ri sjell freski mendimi, energji, vlera dhe perspektiva të reja. Ushtria, si çdo institucion dinamik, ka nevojë për këtë energji rinore që e sfidon rutinën, që kërkon mënyra më të mira, më efikase dhe më bashkëkohore për t'u përballur me sfidat e kohës.

TË MENDUARIT KRITIK SI FORCË, JO SI KUNDËRSHTI

Në një mjedis ushtarak, shprehja e mendimit ndryshe nuk duhet parë si kundërshti ndaj komandës, por si një akt përgjegjësie dhe profesionalizmi. Të mendosh ndryshe nuk do të thotë të mos respektosh rregullat apo urdhrat, do të thotë të kërkoresh mënyra për t'i përmirësuar ato, të ndihmosh në ngritjen e standardeve, dhe të ofrosh zgjidhje më të mençura.

Oficerët e rinj duhet të ndihen të inkurajuar për të analizuar, për të pyetur “pse” dhe “si mund të bëhet më mirë”, sepse vetëm përmes këtij procesi zhvillohet një ushtri menduese dhe e aftë për t'u përshtatur me ndryshimet strategjike e teknologjike të kohës.

KULTURA E DIALOGUT NË UNIFORMË

Një ushtri e fortë ndërtohet mbi besimin dhe komunikimin. Komandanti që dëgjon ushtarin e tij fiton jo vetëm respektin, por edhe një pasqyrë më të gjerë mbi gjendjen reale në terren.

Ndaj, nxitja e dialogut brenda strukturave ushtarake është një shenjë pjekurie organizative.

Nëpërmjet diskutimeve profesionale, analizave dhe debateve të hapura, përgatiten liderët e së ardhmes.

Ata mësojnë të argumentojnë, të dëgjojnë dhe të marrin vendime me përgjegjësi.

**TË RINJTË, PASURIA STRATEGJIKE
E FORCAVE TË ARMATOSURA**

Rinia nuk është vetëm energji fizike. Ajo është burim idesh, inovacioni dhe guximi për të parë përtej rutinës. Në çdo stërvitje, mision, apo detyrë, ushtarakët e rinj janë pasqyrë e së ardhmes. T'i japësh zë mendimit të tyre, është të ndërtosh themelet e një ushtrie që nuk i trembet ndryshimit.

Prandaj, çdo i ri në uniformë duhet ta dijë: ushtria nuk kërkon vetëm bindje, por edhe mendim. Nuk kërkon vetëm zbatim, por edhe kuptim.

GUXONI TË MENDONI, GUXONI TË FLISNI

Të shprehësh mendimin nuk është shenjë dobësie, por shenja më e lartë e formimit profesional dhe qytetar.

Në fund të fundit, historia e çdo ushtrie moderne është ndërtuar nga ata që patën guximin të mendonin ndryshe, të pyesnin, dhe të përmirësonin sistemin.

Ndaj, mos e konsideroni veten tepër të rinj për të menduar e folur. Shprehni mendimin tuaj me respekt, me argument dhe me dashuri për uniformën që mbani.

Zëri juaj, kur është i drejtë dhe i ndershëm, është zëri i së ardhmes së ushtrisë shqiptare.



Kur ëndrra vishet me uniformë: Kadetët e rinj nisin jetën ushtarake në Akademinë ‘Skënderbej’

Dita kur ëndrra bëhet detyrë

Mëngjesi i 6 tetorit kishte diell të butë vjeshte dhe një frymë solemniteti që ndihej në çdo cep të Akademisë së Forcave të Armatosura “Skënderbej”. Oborri kryesor i Akademisë, i zbukuruar me flamuj kombëtarë dhe stema ushtarake, gumëzhinte nga emocionet e familjarëve, oficerëve dhe kadetëve të rinj, djem dhe vajza që nisinin rrugëtimin e tyre si oficerë të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë.

Në këtë ditë simbolike, u zhvillua ceremonia zyrtare e hapjes së vitit të ri akademik 2025–2026, një ngjarje që për çdo student të vitit të parë shënon një kthesë të madhe në jetë: fillimin e rrugës drejt nderit, disiplinës dhe përkushtimit ndaj atdheut.

Në ceremoninë e zhvilluar në ambientet e Akademisë morën pjesë ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të

Armatosura, gjenerallejtënant Arben Kingji, si dhe komandanti i Akademisë, kolonel Bardhyl Nuredinaj, të shoqëruar nga drejtues të tjerë të lartë të ushtrisë dhe pedagogë të Akademisë.

Pas ekzekutimit të himnit kombëtar dhe ngritjes solemne të flamurit, u ndje qetësia karakteristike e momenteve të mëdha. Zërat u shuan, dhe në ajër qëndronte vetëm përzierja e emocioneve, krenarisë dhe respektit.

Zëri i Akademisë dhe mesazhi i udhëheqjes

Komandanti i Akademisë, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, në një ton emocional, iu drejtua kadetëve të rinj me fjalët: “Nga sot, uniforma që mbani mbi supe nuk është thjesht veshje, por përgjegjësi. Ajo simbolizon nderin, sakrificën dhe dashurinë për atdheun. Do të ketë ditë të vështira, por çdo hap që bëni brenda këtyre mureve do t’ju bëjë më të fortë. Oficeri modern nuk është vetëm ushtarak, por edhe intelektual, lider, dhe qytetar model. Akademia e Forcave të Armatosura është themeli mbi të cilin ndërtohet struktura e sigurisë sonë kombëtare”, - mbylli fjalën e rastit gjeneral brigade Nuredinaj.

Ndërsa nga ana e tij ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, në fjalën e tij përshëndetëse theksoi misionin fisnik të të rinjve që zgjedhin këtë rrugë: “Sot nuk është thjesht një ditë e zakonshme akademike. Sot nis rrugëtimi i brezit të ri që do të mbrojë kufijtë, dinjitetin dhe sovranitetin e vendit tonë. Ju jeni shpresa e një





ushtrie moderne dhe profesionale, bijtë dhe bijat që do ta mbajnë flamurin kombëtar lart në çdo detyrë”.

Fjalët e ministrit u shoqëruan me duartrokitje të gjata nga prindërit dhe të afërmit, shumë prej të cilëve mbanin lot gëzimi në sy, ndërsa shihnin bijtë e tyre me uniformë për herë të parë.

Emocione, krenari dhe lot gëzimi

Në mesin e të pranishmëve, emocionet e familjarëve ishin të prekshme. Një nënë, me sytë e përplotur, teksa ndihej krenare para madhësisë së uniformës ushtarake e cila hijeshonte shtatin e djalit të saj shprehet: “Është një ndjenjë e jashtëzakonshme. Kam dhimbje që largohet nga shtëpia, por më shumë kam krenari. Ai po ndjek ëndrrën që kishte që fëmijë, t’i shërbejë vendit të vet”, – tregon ajo me zërin që i dridhet nga emocion.

Në anën tjetër, një baba, ish-ushtarak në pension, vështronte me sy të ngrohtë rreshtin e gjatë të kadetëve: “E kam kaluar edhe vetë këtë rrugë. Sot e shoh djalin tim të veshur me të njëjtën uniformë, dhe kjo është ndoshta dhurata më e bukur që mund të marrë një prind shqiptar”.

Parada e betimit dhe fillimi i misionit

Pas fjalimeve zyrtare, kadetët e vitit të parë, të rreshtuar me përpikëri, zhvilluan një paradë simbolike përpara të pranishmëve. Rrugëtimi i tyre në Akademi zyrtarisht kishte filluar. Uniformat e reja, çizmet që gumëzhnin mbi asfalt, dhe ritmi i komandave të qarta krijuan një atmosferë që përshkonte çdo të pranishëm me emocion.

Në fund të ceremonisë, flamuri i Akademisë u valëvit krenar mbi sheshin qendror, ndërsa të rinjtë, me shikim të vendosur, u drejtuan drejt godinave të tyre të para akademike. Një faqe e re e jetës së tyre kishte nisur.

Një trashëgimi që vazhdon

Akademia e Forcave të Armatosura që prej themelimit të saj, ka qenë vatër formimi për mijëra oficerë që kanë

shërbyer me dinjitet në mbrojtje të vendit. Këtë vit, me pranimin e brezit të ri të kadetëve, Akademia jo vetëm që ruan traditën, por e përforcon atë me programe moderne trajnimi, bashkëpunime ndërkombëtare dhe metoda bashkëkohore mësimdhënieje.

Një ditë që do të mbahet mend

Teksa dielli i pasdites filloi të ulej mbi oborrin e Akademisë, një ndjesi e përbashkët krenarie përshkonte çdo fytyrë. Në rreshtat e kadetëve, në sytë e prindërve dhe në buzëqeshjet e oficerëve, dukej e njëjta shpresë: që këta të rinj do të jenë vazhdimësia e denjë e brezave që kanë mbrojtur flamurin kuqezi me nder.

Në portën e Akademisë, një pankartë e madhe lexonte: “Nder, Atdhe, Sakrificë – Rruga fillon këtu”

Dhe vërtet, për brezin e ri të kadetëve të vitit 2025, rruga e jetës dhe e detyrës kishte filluar pikërisht aty, nën hijen e flamurit shqiptar dhe tingujt e betimit për atdheun.



UNIFORMA QË FORMON NJERËZ:

Nga agimi i Bunavisë te Betimi për Atdheun

Reportazh nga Qendra e Arsimitit Profesional të Ushtarit, Bunavi

Në agimin e çdo dite, përpara se dielli të ngjitet mbi kodrat e Bunavisë, ajri i ftohtë përziehet me zërin e ziles që dëgjohet në orën 05:55. Ky tingull, i cili shënon fillimin e ditës për studentët e vitit të parë të Akademisë së Forcave të Armatosura, është shumë më tepër se një zgjim i zakonshëm, është sinjali i një transformimi të thellë, rrugëtimi që i shndërron të rinjtë civilë në ushtarake të ardhshëm të Republikës së Shqipërisë.

Në Qendrën e Arsimitit Profesional të Ushtarit (QAPU), Bunavi, çdo mëngjes nis me një ndjenjë përgjegjësie dhe përkushtimi. Brenda pak minutash, korridoret mbushen me zhurmën e këmbaleve dhe me zërat e komandave që përplasen mbi muret e bardha të fjetinës. Në sheshin e rreshtimit, ajri i pastër i mëngjesit përziehet me frymën e bashkimit. Studentët formohen në rresht, ndërsa komandantët japin urdhrat e para të ditës.

Ritmi i disiplinës dhe sfidës

Në orën 06:00, me komandën “Në vend! Filloni përgatitjen fizike!”, sheshi gjallërohet. Vrap i mëngjesit, i shoqëruar nga këngë me frymë patriotike, shndërrohet në një himn të vendosmërisë dhe qëndrueshmërisë. “Çdo hap është një hap drejt forcës, çdo frymëmarrje është betim për Atdheun”, thotë një prej instruktorëve, ndërsa studentët kalojnë përmes pistës së stërvitjes me një ritëm që bashkon trupin dhe shpirtin në një të vetme.

Pas ushtrimeve fizike, vjen momenti i përkujdesjes për pastërtinë dhe higjienën – një element i pandashëm i kulturës ushtarake.

Uniforma ushtarake vishet me kujdes, çdo palosje ka

kuptim, çdo detaj përfaqëson respektin për simbolin dhe flamurin kombëtar. Studentët e rinj mësojnë se disiplina nuk është vetëm urdhër, por mënyrë jetese.

Nga auditorët tek stërvitjet – mësimi i ligjit dhe armës

Në orën 08:10, fillon procesi mësimor. Auditorët e Bunavisë mbushen me qetësi e përqendrim, ndërsa zhvillohen modulet themelore: “Rregullorja e Ligjshmërisë”, “Rregullorja Rreshtore” dhe “Përgatitja e Zjarrit”.

Në orët e ligjshmërisë, studentët njihen me bazat juridike të veprimtarisë ushtarake me ligjin e disiplinës, të përgjegjësisë dhe të sjelljes nën uniformë. “Ushtaraku është përfaqësues i ligjit, shembull i drejtësisë dhe integritetit”, shpjegon pedagogu i modulit, ndërsa auditorët ndjekin me vëmendje çdo fjalë.

Në modulën e rregullores rreshtore, studentët



mësojnë sjelljen dhe qëndrimin para eprorëve, komandat, drejtqëndrimin dhe veprimet kolektive. Këtu, më shumë se kudo, kuptohet se forca e ushtrisë qëndron në unitet dhe respektin e hierarkisë.

Ndërsa në modulën e përgatitjes së zjarrit, studentët njihen me armët kryesore të këmbësorisë, mësojnë rregullat e sigurisë dhe teknikën e përdorimit. Në çdo qitje, ata kuptojnë se arma është përgjegjësi – një simbol që kërkon vetëpërmbytje dhe profesionalizëm.

Një ditë nën rregullin e orës ushtarake

Në orën 13:00, zëri i komandës “Në mensë!” thyen ritmin e mësimin. Studentët rreshtohen për drekë, ku çdo rregull, nga hyrja në mensë deri te ngritja nga tavolina, është pjesë e edukimit ushtarak. Pushimi është i shkurtër, por i vlefshëm për të rikuperuar energjitë dhe për të reflektuar mbi përvojat e ditës.



Pasditë, në orën 16:00, rikthehet përgatitja fizike dhe pastrimi i ambienteve. Çdo detaj kontrollohet me përpikëri nga oficeri i ditës, që mbikëqyr respektimin e disiplinës. Në orën 18:30 zhvillohet darka, e ndjekur nga momentet e reflektimit dhe studimit individual në orën 19:30. Në këtë orë, çdo student përqendrohet në detyrat e marra, duke forcuar njohuritë dhe përgatitur mendjen për sfidat e ardhshme.

Në orën 21:30 kryhet kontrolli i mbrëmjes dhe jepen porositë për ditën pasuese. Në orën 22:00, komanda “Gjumë!” shënon fundin e ditës. Por edhe atëherë, jeta ushtarake nuk ndalet: zhvillohet instruktazhi dhe kontrolli i dijeve mbi shërbimin e postës së fjetinës, ku studentët mësojnë gatishmërinë dhe vigjilencën, cilësi që e dallojnë ushtarakun nga çdo profesion tjetër.

Pesë javë që ndryshojnë gjithçka

Trajnimi bazë në QAPU zgjat pesë javë intensive. Çdo ditë është një përballje me lodhjen, por edhe një fitore e karakterit. Studentët mësojnë të punojnë në grup, të respektojnë urdhrat dhe të vendosin interesin e kolektivit mbi atë personal. Kjo periudhë kulmon me realizimin e dy qitjeve familjarizuese dhe testuese me armët e këmbësorisë – një provë e aftësisë, përqendrimit dhe besimit në vetvete.

Në fund të këtij udhëtimi, çdo student e ndien ndryshimin. Nga një civil i zakonshëm, ai është shndërruar në një njeri me mision, një mbrojtës të paepur të vlerave të Atdheut. Nën udhëheqjen e komandantëve, pedagogëve dhe grupit komandues, ata dalin nga Bunavia më të fortë, më të disiplinuar dhe me një ndjenjë të re përkatësie.



Një shkollë jete nën uniformë

Trajnimi bazë në Bunavi nuk është thjesht një fazë përgatitjeje, por një shkollë jete. Aty mësohet se disiplina është liri, bashkimi është forcë dhe respekti për uniformën është nder. Në çdo hap, studentët ushtarakë mësojnë se të jesh pjesë e Forcave të Armatosura është më shumë se një profesion – është një thirrje, një përkushtim për të mbrojtur flamurin dhe sovranitetin e vendit.

Në Bunavi, civilët vijnë me ëndrra, por largohen si ushtarakë me karakter, guxim dhe dashuri për Atdheun. Dhe ky është transformimi më i bukur që ndodh mes kodrave të qeta të Qendrës së Arsimimit Profesional të Ushtarit, ku çdo ditë lind një brez i ri mbrojtësish të Shqipërisë.





FJONGO ROZË MBI UNIFORMË: ***Historia e guximit, shpresës dhe ringritjes***

Intervistë me nënkolonelen Esmihan Durbaku

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Me zemrën e një ushtarakeje dhe shpirtin e një luftëtareje: Historia e Nënkoloneles Esmihan Durbaku

Në kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit për luftën kundër kancerit të gjirit, sjellim një histori që frymëzon, prek dhe forcon besimin në forcën e njeriut për të përballuar çdo sfidë të jetës. Historia e nënkoloneles Esmihan Durbaku, është dëshmi e gjallë se forca shpirtërore, vendosmëria dhe shpresa janë armët më të fuqishme në çdo betejë, qoftë ajo në fushën e detyrës, apo përballë një sëmundjeje që sfidon trupin dhe shpirtin. Me një karrierë të gjatë dhe të respektuar në uniformë, nënkolonelja Durbaku është shembull i një gruaje që nuk është mposhtur nga vështirësitë. Ajo ka luftuar me dinjitet dhe guxim jo vetëm për atdheun, por edhe për jetën e saj, duke frymëzuar kolegë, familjarë dhe gra të tjera që përballen me të njëjtin realitet. Përmes kësaj interviste, synojmë të përcjellim një mesazh fuqie, shprese dhe ndërgjegjësi, se çdo betejë mund të fitohet, kur ka dashuri për jetën dhe besim në vetvete.

Nënkolonele Durbaku, na tregoni pak më shumë për veten dhe rolin që mbani në Akademinë e Forcave të Armatosura.

Faleminderit për ftesën dhe për mundësinë që të ndaj historinë time. Aktualisht jam me detyrë Pedagogë në Departamentin e Operacioneve Ushtarake, Kolegji i Mbrojtjes dhe Sigurisë, ku prej shumë vitesh punoj me përkushtim për formimin e brezave të rinj të oficerëve. Kryejmë kurset e karrierës së oficerëve, për vazhdimësinë e tyre në karrierë dhe kryerjen e detyrave në strukturat e Forcave të Armatosura dhe jo vetëm.

Roli im përfshin drejtimin, mentorimin dhe përgatitjen profesionale të oficerëve të rinj, por mbi të gjitha, është një mision për të transmetuar vlera si disiplina, përgjegjësia dhe dashuria për atdheun. Të jesh pjesë e kësaj akademie është nder dhe përgjegjësi, sepse aty formohen ata që nesër do të mbrojnë vendin tonë.

Çfarë ju motivoi të zgjidhnit një rrugë kaq sfiduese si ajo ushtarake, që kërkon disiplinë, sakrificë dhe përkushtim të vazhdueshëm?

Që në rini kam ndjerë një thirrje të brendshme për t'i shërbyer vendit tim. Nuk ishte një zgjedhje e

rastësishme ishte një vendim i vetëdijshëm për t'u bërë pjesë e një sistemi që ndërton karaktere. Më ka tërhequr gjithmonë ndjenja e drejtësisë, disiplinës dhe përkushtimit. Ushtria është një shkollë jete: të mëson të qëndrosh e fortë edhe kur gjithçka duket e vështirë. Më motivon ndjenja e misionit, e përgjegjësisë, dhe dëshira për të qenë shembull për vajzat që ëndërrojnë të ndjekin të njëjtin rrugëtim.



Cili ishte momenti kur mësuat për diagnozën tuaj me kancerin e gjirit? Si e përjetuat atë lajm?

Ishte një ditë që do të mbetet përgjithmonë në kujtesën time. Lajmi erdhi papritur, në një periudhë kur jeta ime rridhte mes punës dhe familjes. Kur dëgjova fjalët e mjekut, për disa sekonda gjithçka rreth meje humbi kuptim.

Ndjeva frikë dhe pasiguri, por shumë shpejt u ngrita. Thashë me vete: “Unë jam ushtarake. Kjo është beteja ime dhe do ta fitoj”. Në atë moment vendosa të mos dorëzohesha, as para sëmundjes, as para frikës.

Si ndikoi kjo përvojë në jetën tuaj personale dhe profesionale? A pati momente të dobësie apo pasigurie për të ardhmen?

Sigurisht që po. Ka ditë kur forca të braktis dhe çdo hap duket i rëndë. Por vendosa të mos e lejoj sëmundjen të më përcaktojë kush jam.

Në punë, vazhdova pa ndërprerje. Rutina, kolegët dhe ndjenja e misionit më dhanë energji. Në aspektin personal, kuptova se jeta nuk matet me sa kemi, por me sa dashuri japim. Çdo ditë u bë një dhuratë, çdo buzëqeshje një fitore e vogël.

Cila ishte mbështetja më e madhe gjatë kësaj periudhe, familja, kolegët, mjekët apo forca juaj e brendshme?

Të gjitha bashkë...

Familja ime ishte forca ime kryesore, më dhanë dashuri, besim dhe guxim.

Kolegët e mi më bënë të ndihesha pjesë e një familjeje të madhe, më qëndruan pranë dhe më motivuan. Mjekët më dhanë siguri dhe profesionalizëm, por në fund, forca më e madhe erdhi nga brenda vetes, nga dëshira për të jetuar, për të parë fëmijët e mi të rriten, për të vazhduar misionin tim në jetë.

Si e përballuat trajtimin dhe cilat ishin momentet më të vështira në këtë rrugëtim?

Trajtimi ishte i gjatë dhe i lodhshëm, kimioterapi, ndër-

rhyrje, radioterapi, analiza pa fund.

Ka pasur ditë kur trupi nuk kishte më fuqi, por shpresa nuk më la asnjëherë.

Në çdo errësirë gjente një dritë të vogël, një arsye për të buzëqeshur.

Çdo mëngjes, kur hapja sytë, falënderoja Zotin që isha ende aty, në betejën për të jetuar.

A ju ndihmoi përvoja ushtarake për ta përballuar këtë sfidë shëndetësore?

Absolutisht po. Ushtria më ka mësuar të mos dorëzohem, të ruaj qetësinë dhe të luftoj me strategji. Disiplina më ndihmoi të ndjek trajtimet me përpikëri, ndërsa organizimi më lejoi të menaxhoja më mirë emocionet.

Kjo përvojë ma kujtoi se uniforma që mbajmë nuk është vetëm simbol, por një mënyrë jetese që na jep forcë në çdo front, edhe në atë më personalin.

Çfarë mësimesh të rëndësishme keni nxjerrë nga kjo përvojë? Si ka ndryshuar mënyra se si e shihni jetën dhe njerëzit?

Kam mësuar se jeta është e çmuar dhe çdo moment duhet jetuar me vetëdije e mirënjohje. Kam rishikuar prioritetet e mia: familja, dashuria, shëndeti, këto janë pasuritë e vërteta.

Në punë jam bërë më e ndjeshme, më njerëzore dhe më e hapur ndaj emocioneve të tjerëve. Kjo betejë më ka mësuar se çdo vështirësi mund të shndërrohet në mundësi për rritje.

Çfarë mesazhi do t'u jepnit grave dhe vajzave që përballen me një sfidë të ngjashme?

Grave do t'u thosha: mos kini frikë, mos humbni shpresën dhe mos e ulni kokën para sëmundjes. Besoni tek Zoti, tek mjekët dhe mbi të gjitha, tek vetja.

Kërkoni ndihmë, flisni hapur, mos u izoloni. Çdo hap drejt shërimit është një fitore.

Kjo sëmundje nuk është fundi, është një sfidë që mund të fitohet me dashuri, kujdes dhe besim.



Si mund të ndihmojë shoqëria dhe Forcat e Armatosura në ndërgjegjësimin për parandalimin e kancerit të gjirit?

Shoqëria duhet të flasë më shumë, të informojë më shumë, të ketë fushata të vazhdueshme ndërgjegjësimi. Forcat e Armatosura janë shembull për disiplinën dhe kujdesin ndaj trupit dhe mendjes.

Nëse ne, gratë në uniformë, tregojmë kujdes ndaj shëndetit tonë, përcjellim një mesazh të fortë për të gjitha gratë shqiptare. Institucionet duhet të mbështesin kontrollet periodike dhe të krijojnë hapësira për diskutim e mbështetje psikologjike.

Çfarë kuptimi ka për ju sot Tetori Rozë?

Tetori Rozë për mua është muaji i jetës, i forcës dhe i reflektimit.

Dikur ishte muaji i frikës dhe i dhimbjes, por sot është simbol i fitores, i bashkimit dhe i shpresës.

Çdo fjongo rozë më kujton se jam gjallë, se kam luftuar dhe fituar, dhe se duhet të jem zëri i atyre grave që ende janë në betejë.

Cili është mesazhi juaj për gratë shqiptare dhe koleget tuaja në uniformë?

Grave shqiptare do t'u them: kujdesuni për veten, bëni kontrole, mos e shtyni kujdesin për shëndetin tuaj. Ne kemi një forcë të brendshme që shpesh nuk e njohim deri në momentin kur sprovohemi.

Çdo hap i vogël drejt përmirësimit është një hap drejt jetës. Mos harroni – ju jeni më të forta se ç' mendoni, më të bukura se ç' besoni dhe më të vlefshme se ç' duket.

Historia e Nënkoloneles Esmihan Durbaku është një thirrje për jetë, shpresë dhe solidaritet. Ajo na mëson se uniforma nuk mbulon vetëm trupin e një ushtarakeje, por edhe shpirtin e një gruaje që nuk dorëzohet.

Tetori Rozë na kujton se parandalimi shpëton jetë, se forca lind nga dashuria për jetën, dhe se çdo grua është një heroinë e heshtur në betejën e saj.



Mbrojtja Civile Shqiptare: Historia, Sfida dhe Angazhimi për Sigurinë e Qytetarëve në Kohë Krize

Intervistë me Komandantin e Bazës së Mbështetjes për Emergjencat Civile (BMEC), Kolonel Hajdar Gurra

INTERVISTOI: ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile zotëron kapacitete teknike bashkëkohore dhe moderne që qëndrojnë në të njëjtin nivel me vendet partnere të NATO-s dhe BE-së. Po bëhet një punë e jashtëzakonshme për mbështetje dhe kompletim të plotë me mjete, pajisje e infrastrukturë nga Autoritetet Civile, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, Komanda Mbështetëse, duke krijuar një strukturë bashkëkohore në përballimin në mënyrë profesionale e efikase të fatkeqësive natyrore.

Zoti komandant, më 1 shtator 1987, u themelua zyrtarisht Mbrojtja Civile pranë Forcave të Armatosura. Si lindi kjo strukturë dhe çfarë domethënie kishte në atë kohë?

Kjo strukturë ushtarake u krijua si përgjigje ndaj nevojës për mbrojtjen e qytetarëve nga fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu dhe natyra. Fillimisht, funksioni kryesor i saj ishte reagimi i shpejtë ndaj këtyre situatave emergjente, duke ofruar ndihmë të menjëhershme për popullsinë e dëmtuar gjatë fatkeqësive natyrore. Krijimi i saj erdhi si një domosdoshmëri për të siguruar mbrojtje dhe ndihmë në situata kritike.

Cilat ishin prioritetet dhe detyrat kryesore në fillimet e saj?

Si një strukturë e re ushtarake, trupat e Mbrojtjes Civile u organizuan në bazë të një strukture regjimenti rajonal. Ata ishin nën varësi të Ministrit të Mbrojtjes dhe kishin të drejtën e përdorimit të tyre nga Këshilli i Ministrave.

Prioritetet dhe detyrat kryesore të këtij regjimenti, të quajtur Regjimenti i Mbrojtjes Civile Rajonale, përfshinin:

- Përballimin e fatkeqësive natyrore gjatë kohës së paqes, duke ofruar ndihmë të menjëhershme popullatës civile.
- Në situata lufte, eliminimin e pasojave në zonat e dëmtuara, kryesisht në qytetin e Tiranës, dhe nëse situata e kërkonte, në qytete të tjera.

Si ka evoluar Mbrojtja Civile gjatë këtyre 38 viteve?

Evolucioni i Mbrojtjes Civile gjatë 38 vjetëve ka kaluar në shumë etapa të rëndësishme dhe sfiduese. Disa nga pikat kryesore përfshijnë:

- Ndryshimet në konceptet mbi Mbrojtjen Civile, duke reflektuar zhvillimet dhe kërkesat e kohës.

- Përshtatja pas ndryshimeve politike dhe ndryshimit të regjimit totalitar në vend.
- Përshtatja e kuadrit ligjor me standardet e vendeve perëndimore, në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut.
- Rëndësia e shtuar si forcë reaguese operacionale për përballimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile.

Vitet '90 sollën sfida të mëdha për gjithë shtetin shqiptar. Si u përball Mbrojtja Civile me ato ndryshime?

Si të gjitha strukturat ushtarake thelbësore dhe kritike për Mbrojtjen Civile, edhe ajo ka pësuar përshtatje të vazhdueshme në përputhje me ndryshimet e mëdha që ka përjetuar ushtria shqiptare. Këto përshtatje strukturore kanë përballuar sfida të mëdha, të cilat kërkojnë: Studim rrënjësor për të siguruar që fleksibiliteti i organizimit të jetë sa më efikas në realizimin e prioritetëve, misionëve dhe detyrave për përballimin e fatkeqësive natyrore.

Një sfidë e veçantë për Mbrojtjen Civile është personeli, ku hasen vështirësi të ndryshme, si: rekrutim i duhur. Qëndrueshmëria dhe përmirësimi i aftësive pas trajnimeve, për shkak të ndryshimeve teknologjike dhe modernizimit të pajisjeve të specializuara. Gjithashtu, një sfidë tjetër kryesore është sigurimi i kapaciteteve operacionale, për të rritur: operabilitetin e njësive, forcën reaguese, efektivitetin në përballimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile në kohë

Cilat kanë qenë momentet më të vështira në rrugëtimin e deritanishëm?

Në këtë rrugëtim plot sfida, ka pasur edhe momente të vështira, ndër të cilat vlen të theksohet viti i mbarsht '97, ku u shkatërrua pothuajse e gjithë in-

frastruktura ushtarake, pajisje speciale, mjete, etj. Ka qenë një ndër momentet më të vështira për MCR, pasi u fillua të ngrihej nga asgjëja.

Aderimi në NATO i Forcave të Armatosura dhe rrugëtimi pas viteve 2000 ka qenë një moment i vështirë dhe shumë i rëndësishëm, ku u desh një punë jashtëzakonisht kolosale për rindërtimin e kuadrit ligjor, futjen e koncepteve të reja operacionale, si dhe trajnimin e personelit për të qenë në të njëjtin nivel me vendet partnere.

Një moment i vështirë ndër vite ka qenë mungesa e motivimit si rezultat i pajisjeve të dobëta dhe rrogave shumë të ulëta, por që me kalimin e viteve dhe ndryshimeve të koncepteve mbi përballimit të EC-ve ka ndryshuar për mirë në këtë drejtim.

Së fundmi ja vlen të shtojmë se në konceptin e trupave të BMEC-së, momente të vështira janë të gjitha momentet ku mundësia për të ndihmuar popullsinë civile i kalon kufijtë e reales.

Po arrijtjet më të rëndësishme, cilat do t'i veçonit?

Për forcat e Mbrojtjes civile çdo lloj arritje veçohet tek arrijtjet e rëndësishme, për shkak të ndjeshmërisë dhe të ndihmës reale dhe efiente që jepet e ndjehet në komunitet në rastet me kritike të tyre, gjatë zhvillimit të operacioneve të emergjencave civile në ndihmë të përballimit të fatkeqësive natyrore. Por ja vlen ta përmendim që ndër arrijtjet që na bëjnë krenar është zhvillimi i operacioneve të EC edhe jashtë kufijve, ku deri tani kemi zhvilluar operacione për shuarje zjarri në Republikën e Greqisë si dhe operacion kërkim-shpëtimi në përballimin e fatkeqësisë natyrore të tërmetit në Republikën e Turqisë.

Si është e organizuar sot Mbrojtja Civile dhe cilat janë komponentët kryesorë të saj?

Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile e organizuar dhe strukturuar në një strukturë të mirëfilltë ushtarake, për një reagim të shpejtë në përballimin e të gjitha fatkeqësive natyrore dhe atyre të shkaktuara nga njeriu. Nënrepartet më të rëndësishme të BMEC-së janë katër kompanitë operacionale dhe detashmenti Mengel, Elbasan, me shtrirje në Tiranë, Elbasan, Vlorë dhe mbulim të të gjithë territorit të Republikës së Shqipërisë. Këto nënreparte kanë detyra specifike të ndara nga njëra-tjera, ku përgjigjen për përballimin e fatkeqësive të shkaktuara nga zjarri, përmbytjet, tërmetet. Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile ka në përbërje nënrepartin e shtabit, qendrën stërvitore për emergjencat civile, kompaninë mbështetëse, ku përpunohet dhe hartohet kuadri ligjor, koordinohen veprimtaritë për operacionet ushtarake, realizohet kryerja e mbështetjes së nënreparteve operacionale për përmbushjen e detyrave dhe kryerjen e operacioneve të EC-ve me sukses.

Në ç'mënyrë bashkëpunon kjo strukturë me institucionet e tjera të vendit?



Struktura jonë ka një bashkëpunim pothuajse perfekt me institucionet e tjera të vendit. Aktivizimi i BMEC-së në operacione për përballimin e EC-ve, operacioneve të kërkim-shpëtim, realizohet nëpërmjet zinxhirit të komandimit që fillon nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura. Bashkëpunim shumë të mirë kemi me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, qoftë institucional ashtu edhe të forcave në terren. Kemi një bashkëpunim korrekt nëpërmjet planeve të bashkëpunimit me seksionet EC-ve me prefekturat e bashkitë e vendit.

Sa i rëndësishëm është bashkëpunimi ndërkombëtar dhe integrimi me standardet e NATO-s dhe BE-së?

Me sfida të reja, kushtëzuar nga globalizmi, një bashkëpunim përtej kufijve, me partnerët dhe aleatët tanë është sa i rëndësishëm aq edhe kritik, gjë e cila bën të mundur përmbushjen e një sërë sfidash në drejtim të profesionalizmit dhe ekspertizës për të reaguar në mënyrë efektive, mbi parandalimin, reduktimin dhe zvogëlimin e risqeve në operacionet për përballimin e EC-ve dhe të kërkim-shpëtim. Përafrimi dhe qasja me standardet e NATO-s dhe BE-së është një domosdoshmëri për BMEC-në. Me ndihmën e Shtabit të Përgjithshëm, Komandës Mbështetëse dhe AKMC-së, jemi futur në një rrugë ku programet e bashkëpunimit, trajnimit si dhe standardizimit të procedurave me vendet e NATO-s, BE-së dhe të rajonit, është bërë obligacion nga ana jonë.

Çfarë roli kanë qytetarët dhe shoqëria civile në sistemin e mbrojtjes civile?

Qytetarët dhe shoqëria civile kanë një rol jashtëzakonisht



të rëndësishëm në sistemin e Mbrojtjes Civile, duke filluar që me sensibilizimin fillestar, detyrimin që kanë për të informuar lidhur me të dhënat që ndihmojnë institucionet publike dhe strukturat e mbrojtjes civile në përbalimin e gjendjes së fatkeqësisë. Përfshirja në detyra të veçanta, në përputhje me përgatitjen, aftësitë dhe me nevojën për të ndihmuar në kapërcimin e gjendjes së fatkeqësisë natyrore civile dhe deri tek mbështetja direkte në operacionet e përbalimit të emergjencave civile, duke pasur detyrimin për zbatimin e urdhrave, të masave dhe të udhëzimeve për ndjekjen e procedurave të kërkuara, në mënyrë të veçantë për evakuimin e detyruar.

Si është gjendja e kapaciteteve teknike dhe njerëzore sot?

Baza e Mbështetjes dhe Emergjencave Civile zotëron kapacitete teknike bashkëkohore dhe moderne që qëndrojnë në të njëjtin nivel me vendet partnere të NATO-s dhe BE-së.

Po bëhet një punë e jashtëzakonshme për mbështetje dhe kompletim të plotë me mjete, pajisje e infrastrukturë nga Autoritetet Civile, Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm, Komanda Mbështetëse, duke krijuar një strukturë bashkëkohore në përbalimin në mënyrë profesionale e efikase të fatkeqësive natyrore. Për sa i përket kapaciteteve njerëzore kemi nevojë për kompletim, ku në planet afatshkurtra është më se i realizueshëm. Kapacitetet njerëzore aktuale janë të motivuar, të mirë trajnuar edhe pse tek ne trajnimi dhe stërvitjet janë një proces i vazhdueshëm brenda vendit ashtu edhe me partnerët ndërkombëtar. Aktualisht

kemi trupa për trajnim e stërvitje në Kosovë e Bullgari.

Çfarë synimesh dhe vizioni keni për të ardhmen e Mbrojtjes Civile?

Synimet dhe vizioni për BMEC-në shkon në drejtim të profesionalizimit, aftësimit dhe trajnimit të kapaciteteve njerëzore sipas doktrinaeve të vendeve të NATO-s dhe BE-së në mënyrë që të krijojmë një trupë operacionale e aftë të operojë brenda dhe jashtë vendit në përbalimin e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile. Rinovimi i teknikës, pajisjeve, në mënyrë periodike dhe në koherencë me zhvillimet teknologjike është një synim dhe vizion që për ne është një kusht që duhet realizuar. Ndryshimet strukturore të mundshme për përafrimin e strukturës aktuale me strukturat homologe të vendeve partnere, në mënyrë që të rrisim nivelin e bashkëpunimit dhe operimit të ndërsjellë me vendet e NATO-s, BE-së dhe atyre të rajonit ngelet një synim dhe sfidë për BMEC-në. Motivimi i kapaciteteve njerëzore si nga ana financiare por edhe nxitja e mbështetja e vetëzhvillimit të tyre personal ngelet një synim për t'u realizuar, duke siguruar gjetjen e burimeve mbështetëse.

Cili është mesazhi juaj për qytetarët shqiptarë në këtë përvjetor të krijimit të Mbrojtjes Civile?

Mesazhi im që shkon për qytetarët është të reagojnë sa më shpejt në njoftimin e autoriteteve të mbrojtjes civile mbi ekzistencën e fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile si dhe të kenë besimin e plotë se ne do të jemi aty në përbalimin e këtyre Emergjencave Civile si dhe lehtësimin e shkallës së dëmtimit të të prekurve ndaj këtyre fatkeqësive.



Opinion

ANJEZA MUSOLLARI,

Shefe e Sektorit të Botimeve

HIPOKRIZIA, maska e njerëzimit në kohën moderne

Njeriu ndërmjet sinqeritetit dhe hipokrizisë

Në çdo epokë, njeriu është përpjekur të kuptojë vetveten, të mirën dhe të keqen, dritën dhe errësirën, njeriun dhe djallin brenda tij. Por sot, në një shoqëri që përparon me shpejtësi në teknologji e pasuri materiale, duket se një vlerë themelore po humbet: ndershmëria.

Sytë që qeshin, por zemra që tradhton

“Ç’do çast në sy të buzëqesh./ Të flet ëmbël sikur më parë./ Por ai pret ditën që të ta ngjeshë./ Me thikë pas shpine për të të vrarë.”

Në një botë ku fasada vlen më shumë se përmbajtja, njeriu është kthyer në maskë.

Shoqëria e fasadave dhe kultura e dukjes

Rrjetet sociale, marrëdhëniet sipërfaqësore dhe karrierizmi pa vlera, kanë krijuar një kulturë të re: atë të dukjes, jo të qenies. Në këtë botë, hipokrizia lulëzon. Secili përpiket të shfaqet “i përsosur”, ndërsa realiteti shpirtëror është gjithnjë e më bosh.

Si mund të ndërtohet një shoqëri e drejtë kur themelet e saj qëndrojnë mbi mashtrimin dhe

vetë-gënjeshtëri?

Filozofia e ndershmërisë

Ndershmëria, edhe pse shpesh shihet si dobësi, është forca më e madhe që mund të ketë njeriu. Ai që qëndron i drejtë edhe kur e sulmojnë, është fitimtari i vërtetë, jo ai që fiton me mashtrim.

Hipokrizia, plagët e moralit modern

Në jetën e përditshme, hipokrizia është bërë pjesë e zakonshme e marrëdhënieve tona. Njerëzit ndihen të detyruar të paraqesin një version të përkryer të vetes, duke fshehur dobësitë. Por kjo sjell ndarje të brendshme, stres dhe mungesë autenticiteti.

Kështu lind ndërprerja midis fjalës dhe veprës, ku njeriu nuk di më kush është veçse një imazh i vetvetes.

Të dukesh apo të jesh?

Hipokrizia është mospërputhja mes fjalëve dhe veprave. Hipokriti kërkon miratim kërkon pushtet, por në fund, humb kontaktin me të vërtetën.

Sjellje kjo që shkatërron jo vetëm marrëdhëniet njerëzore, por edhe shëndetin mendor dhe shpirtëror. Jetesa me maskë sjell lodhje, stres dhe zbrazëti. Dhe pa e kuptuar ka humbur lidhjen me veten.

Sinqeriteti si akt guximi

Hipokrizia është sëmundje e ndërgjegjes njerëzore, që lindin kur njeriu humb lidhjen me të vërtetën. Të jetosh sipas vullnetit të Zotit do të thotë të jesh i pastër në zemër, i drejtë në veprime dhe i përlurur në shpirt.

Në një shoqëri që na shtyn të dukemi më shumë sesa të jemi, sinqeriteti është guxim. Vetëm kur guxojmë të jemi të vërtetë, mund të ndërtojmë marrëdhënie të shëndetshme dhe një paqe të brendshme që nuk ka nevojë për maska.

Në një botë me shumë fasada, të jesh i vërtetë është revolucion

Autenticiteti nuk është thjesht një vlerë personale, por një akt i guximshëm dhe shpesh i rrezikshëm. Në një shoqëri ku retorika e madhështisë, deklaratat e bukura dhe sjellja e përshtatur janë norma, të shfaqësh të vërtetën tënde kërkon sfidim.

Ai që zgjedh sinqeritetin mbi hipokrizinë shpesh rrezikon të përballet me paragjykime, izolim apo mospranim. Por ky është çmimi i lirisë morale. Hipokrizia, ndërkohë, vepron si një helm i heshtur. Ajo kthen marrëdhëniet njerëzore në lojë intereseash dhe maskimesh, duke fshirë lidhjen autentike midis individëve. Një njeri i vërtetë, nga ana tjetër, nuk shkon gjithmonë përputhje me pritshmëritë; ai ose ajo sfidon normat, por krijon një hapësirë për besueshmëri dhe integritet. Ky tension midis dukjes dhe thelbit është një nga paradokset më të mëdha të jetës shoqërore moderne.

Të qenit i vërtetë nuk është vetëm një akt personal, por një provokim etik. Ai që zgjedh transparencën mbi hipokrizinë nuk ndërton vetëm karakterin e tij, por shërben si shembull dhe sfidë për komunitetin.

Në një epokë të mbushur me fasada, çdo veprim i sinqertë është një revolucion i heshtur, por i fuqishëm.

Në një botë ku maskat janë normë, autenticiteti shndërrohet në akt rebel. Hipokrizia është fitore e përkohshme, por e vërteta është trashëgimi. Revolucion i brendshëm i secilit prej nesh fillon aty ku vendosim të jemi të sinqertë, edhe kur e gjithë bota duket se kërkon të ndryshe.



GRATË QË MBAJTËN **kombin mbi supe:**

Nga Nora e Kelmendit te Nënë Tereza

Gratë sakrifikuese që e ngjiten në altar misionin e nënës

Në historinë e popullit shqiptar, pak figura mbartin peshën dhe madhësinë që ka nëna shqiptare. Ajo qëndron në themelet e identitetit tonë kombëtar, në çdo brez dhe në çdo kohë, si një shtyllë e qëndresës morale dhe shpirtërore. Në tekstin “Gratë sakrifikuese që e ngjiten në altar misionin e nënës”, ndeshemi me një përjetim të thellë, një homazh poetik dhe njerëzor për gruan që ka lindur, rritur dhe mbrojtur jetën në çdo stinë të vështirësisë.



Sakrifica që shndërrohet në shenjtëri

Fotografia e gruas shqiptare që mban djepin në shpinë me fëmijën brenda tij është shumë më tepër se një kujtim nga e kaluara. Ajo është një ikonë e përjetshme e vetëmohimit. Në çdo hap, ajo bartte jo vetëm peshën e trupit të fëmijës, por edhe peshën e përgjegjësisë, të dashurisë dhe të ekzistencës. Nëna e përshkruar në këtë tekst është gruaja që, edhe pse e lodhur nga puna e rëndë, nga shiu dhe erërat e stuhishme, nga pritjet e pafundme, nuk e ndan fëmijën nga vetja. Ajo është strehë, mburojë dhe jetë, një simbol që përmbledh të gjitha format e përkushtimit njerëzor.

Nëna, misionare e jetës dhe trashëgimisë

Në çdo fjali të këtij materiali, nëna ngrihet në pedestalin e nderimit. Ajo nuk pranon të jetë “e përçmuar nga kodet zakonore”, por e shpall veten misionare të jetës dhe trashëgimisë së brezave. Në trupin e saj fillon jeta, në kraharorin e saj ushqehet dashuria, dhe në duart e saj formohet njeriu i ardhshëm. Në këtë dimension, nëna shqiptare bëhet simbol i vijimësisë së kombit, ashtu si ushtari që ruan kufijtë e vendit, ajo ruan kufijtë e

shpirtit, të traditës dhe të qëndresës sonë.

Një mësim për brezat e sotëm

Nëna shqiptare e dikurshme, që shkelte mbi baltë me djepin në shpinë, përfaqëson thelbin e fortësisë që çdo brez duhet ta njohë e ta nderojë. Ajo s'kërkoj kurrë lavdi, as përmendore; kërkoi vetëm të shihte fëmijën e saj të rritur, të shëndetshëm dhe të ndershëm. E megjithatë, siç e thekson autori, "shpirti i plasi për një fjalë të mirë dhe një dorë që i'a paqton dhimbjet", një kujtesë se mirënjohja është detyrimi më fisnik i çdo shoqërie ndaj nënës.

Nëna, ushtarja e parë e jetës

Nëna shqiptare është ushtarja e parë e jetës, ajo që ka mbrojtur kombin në heshtje, pa armë, por me zemër, me duar të lodhura dhe me shpirt të pathyeshëm. Ashtu si çdo ushtar që mbron atdheun në kufi, ajo ka mbrojtur jetën në vatrën e saj. Nëna është forca morale e një ushtrie të tërë populli, që ka ditur të mbijetojë, të punojë e të shpresojë, edhe në kohët më të errëta.

Altari i mirënjohjes

Figura e nënës shqiptare nuk i përket vetëm të shkuarës; ajo është trashëgimi shpirtërore e kombit tonë. Sot, kur shoqëria përpiket të ruajë vlerat dhe të ndërtojë të ardhmen mbi themele të forta, nderimi për nënën është nderimi për jetën vetë. Nëna është, dhe do të mbetet, altari i përhershëm i dashurisë, i sakrificës dhe i qëndresës. Figura e nënës shqiptare nuk është vetëm simbol i dashurisë e përkushtimit, por edhe i trimërisë dhe guximit, shpesh të heshtur, por të thellë dhe madhështor.

Nënë Tereza (Gonxhe Bojaxhiu)

Edhe pse jo në kuptimin luftarak të trimërisë, ajo është nëna shpirtërore e njerëzimit. Trimëria e saj qëndron në përballjen me varfërinë, sëmundjet dhe vdekjen me dashuri e mëshirë. Në kohë kur shumë e shmangnin mjerimin, ajo u fut në zemrën e tij për t'i shërbyer njerëzimit me mirësi.

Nora e Kelmendit

Një nga figurat më të fuqishme të historisë shqiptare. Me zgjuarsin e guxim, ajo vrau pashain turk që kishte përdhunuar ndershmërinë e fshatit të saj. Trimi mund të ngrejë armën, por Nora ngriti nderin dhe e mbrojt me gjak. Ajo është simbol i nënës dhe gruas që s'e pranon poshtërimin dhe që vë jetën në rrezik për dinjitetin e kombit.

Shote Galica (Qerime Radisheva)

Grua e armëve, bashkëshorte e trimit Azem Galica, por mbi të gjitha nënë e luftës dhe e idealeve kombëtare. Në një kohë kur shumë gra nuk dilnin nga shtëpia, ajo mori

pushkën në krah dhe luftoi në krah të burrave për çlirimin e Kosovës. Në fjalët e saj të fundit: "Shqipëria e lirë le të rrojë, se unë po vdes e qetë", gjendet trimëria e nënës që nuk njeh frikë.

Nënë Pashako

Një figurë popullore e Luftës Nacionalçlirimtare. Kur i ra djali dëshmor, ajo doli para njerëzve dhe tha:

"Mos qani, djali im ra për Shqipërinë, e unë do t'i rris të tjerët për të njëjtin flamur".

Kjo është trimëria e dhimbjes së përmbajtur, e nënës që shndërron lotin në forcë, si shumë nëna të atyre viteve.

Nënë Zaharia nga Dibra

Në kohën e pushtimit osman, ajo mbajti të fshehur luftëtarët shqiptarë në shtëpinë e saj, duke rrezikuar jetën e familjes. Kur u pyet pse nuk u tremb, ajo tha:

"Nëse më marrin jetën, s'kam humbur gjë; nëse humbet Shqipëria, humbasim të gjithë".

Nënat e Kosovës (1998-1999)

Edhe në kohët moderne, trimëria e nënave nuk mungon. Gjatë luftës së fundit në Kosovë, nënat shqiptare mbajtën gjallë fëmijët në mërgim, në male e në kampe, shpesh pa bukë e pa ujë, por me shpresë. Ato janë heroina të heshtura, që ruajtën jetën në kohë kur vdekja ishte e përditshme.

Nënë Hava Rexha, nëna e dëshmorëve

Nga Malësia e Gjakovës, nënë që humbi disa nga djemtë në luftë, por që doli para popullit dhe tha me krenari:

"Unë nuk qaj për bijtë që dhanë jetën, qaj për ata që s'e duan lirinë si ata."

Një shembull i trimërisë morale, që tejkalon frikën dhe dhimbjen.

Nënat e fshatrave që mbajtën jetën gjallë

Edhe pse pa emra në libra, ato janë nënat e zakonshme që mbollën bukë, ruajtën fëmijët, bartën plagët e burrave dhe s'u përkulën kurrë. Në çdo shtëpi shqiptare, ka një nënë që ka treguar trimëri, në heshtje, në sakrificë, në dashuri.

Në historinë tonë, trimëria nuk është vetëm ajo që ngre armën, por ajo që mbron jetën, dinjitetin dhe shpresën. Nëna shqiptare e ka bërë këtë për shekuj me radhë, dhe për këtë arsye, ajo është dhe mbetet ushtarja e parë e jetës.

Nga Redaksia e Gazetës Ushtria

Në nderim të grave sakrifikuese që e ngjiten në altar misionin e nënës – nëna shqiptare, simbol i paepur i dashurisë, jetës dhe atdheut.



Drejt vitit 2030 me “Luftë pa kontakt”



KOLONEL HYSNI GJERGJI

“LUFTA PA KONTAKT OSE ME 3 I-TË, NUK MUND TË EKZISTOJË PA INTELIGJENCË TË FUQISHME PASI INTELIGJENCA JANË “SYTË DHE VESHËT” E LIDERIT USHTARAK DHE MJET PËR TË FITUAR LUFTËN PA PASUR NEVOJË PËR BETEJË TË DREJTPËRDREJTË ME ARMË ZJARRI. INTELIGJENCA NË LUFTËN PA KONTAKT ËSHTË PROCESI I MBLEDHJES, ANALIZIMIT DHE PËRDORIMIT TË INFORMACIONIT MBI ARMIKUN, FUSHËN E BETEJËS, INFRASTRUKTURËN, KOMUNIKIMET, QËLLIMET DHE AFTËSITË E TIJ, PA PATUR KONTAKT FIZIK ME TË. ROLI I INTELIGJENCËS NË LUFTËN PA KONTAKT ËSHTË VENDIMTAR DHE SHPESH ËSHTË FAKTORI KYÇ QË NDAN SUKSESIN NGA DËSHTIMI.

Lufta pa kontakt (non contact warfare) është një strategji ushtarake moderne që minimizon angazhimin fizik ndërsa maksimizon impaktin strategjik, përmes mjeteve të ndryshme, përfshirë operacionet kibernetike, luftën me informacion dhe sulmet me raketa e dronë nga shumë larg. Duke iu afruar vitit 2026, vëmë re se konflikti i armatosur po kalon nga përplasja e tankeve, tek përplasja dhe ndikimi i 3 I-ve: ideve, informacionit dhe influencës janë bërë armë moderne, më të mprehta dhe më strategjike se plumbi. Ndryshimi i natyrës së betejës dhe lufta moderne nuk po ndodh më vetëm në fushëbetejë por edhe në Infrastrukturë (energji, uji, interneti), ekonomi (sanksione, sulme mbi banka) dhe opinion publik (dezinformim, propagandë online). Kjo tendencë kërkon që edhe mbrojtja të përshtatet jo vetëm me radarë dhe armë, por edhe me institucione të forta, arsim cilësor, media të pavarura dhe vetëdije kolektive që janë formësuese të 3 I-ve. Jetojmë në një botë ku më shumë njerëz “vriten” nga manipulimi sesa nga plumbi, armët e ndikimit janë armët e së ardhmes. Kjo është luftë pa uniforma, pa deklarata zyrtare, pa armë tradicionale, por me mjete të tilla si, dronë me rreze të gjatë, sulme kibernetike, operacione psikologjike, fushata dezinformimi.

“Lufta pa kontakt” është një koncept dhe komponent i luftës moderne, që nënkupton përdorimin e teknologjive

të avancuara për të goditur armikun pa qenë nevoja për përplasje të drejtpërdrejta fizike ndërmjet forcave ushtarake. Qëllimi i "luftës pa kontakt" është të neutralizojë armikun nga distanca, duke reduktuar humbjet njerëzore dhe për të rritur efikasitetin operativ. Lufta pa kontakt është mënyra moderne e të luftuarit, ku teknologjia dhe distanca zëvendësojnë përplasjet klasike trup me trup. Kjo lloj lufte synon të minimizojë rrezikun për trupat e veta dhe të maksimizojë efektin përmes distancës dhe inteligjencës teknologjike. Karakteristikat kryesore të luftës pa kontakt janë përdorimi i armëve të sofistikuara me rreze të gjatë veprimi, si raketat, dronët, avionët pa pilot (UAV), artileria me precizion të lartë etj. Me anë të kësaj lufte bëhet dominimi në hapësirën kibernetike dhe informative, përmes sulmeve kibernetike, luftës elektronike, dezinformimit dhe kontrollit të komunikimeve si dhe zbulimi dhe goditja e objektivave në kohë reale, shpesh pa praninë fizike të trupave në terren. Inteligjencë artificiale dhe analizë e të dhënave për të marrë vendime taktike dhe strategjike më shpejt, janë tipare të kësaj lufte. Shembuj konkretë të luftës pa kontakt janë edhe sulmet me dronë në Lindjen e Mesme për të eliminuar objektiva terroristë pa vendosur trupa në terren.

Lufta pa kontakt ose me 3 I-të, nuk mund të ekzistojë pa inteligjencë të fuqishme pasi Inteligjenca janë "sytë dhe veshët" e liderit ushtarak dhe mjet për të fituar luftën pa pasur nevojë për betejë të drejtpërdrejtë me armë zjarri. Inteligjenca në luftën pa kontakt është procesi i mbledhjes, analizimit dhe përdorimit të informacionit mbi armikun, fushën e betejës, infrastrukturën, komunikimet, qëllimet dhe aftësitë e tij, pa patur kontakt fizik me të. Roli i inteligjencës në luftën pa kontakt është vendimtar dhe shpesh është faktori kyç që ndan suksesin nga dështimi. Në këtë lloj lufte, ku përplasjet fizike janë të kufizuara dhe sulmet ndodhin nga distanca, informacioni i saktë dhe në kohë reale është arma më e fuqishme. Sistemet ISR (Intelligence, Surveillance, Reconnaissance) janë pajisje për zbulim dhe vëzhgim në distance, të cilat përdorin taktikat "Shock and awe" (goditje e menjëhershme dhe shkatërruese), si dhe goditje masive me raketa/dronë për të paralizuar aftësinë e kundërshtarit që në fillim.

Zbulimi dhe identifikimi i objektivave është misioni kryesor i inteligjencës dhe synon të gjejë

përgjigjet e pyetjeve çfarë, ku dhe kur të goditet. Kjo arrihet përmes informacionit të satelitëve, dronëve të vëzhgimit, sensorëve tokësorë ose ajrorë dhe analizës së imazheve dhe zërit të përftuar nga (SIGINT, IMINT, HUMINT). Inteligjenca ndihmon për të zbuluar sulme të planifikuara kibernetike, raketore ose terroriste si dhe për t'i ndaluar ato përpara se të ndodhin. Përdorimi i AI-së dhe Big Data nga inteligenca analizon sasi të mëdha informacioni në kohë reale, lidhur me lëvizjet e trupave, komunikimet në rrjete sociale dhe aktivitetet në internet të kundërshtarit. Komandantët ushtarakë por dhe liderët politikë i bazojnë vendimet e tyre mbi inteligjencën ushtarake (p.sh. për të urdhëruar një sulm me dron apo për të bllokuar rrjetin elektrik të armikut. Përdorimi i inteligjencës është i rëndësishëm edhe për të kuptuar mendësinë e armikut dhe për të përhapur dezinformim për të krijuar konfuzion, frikë ose ndarje të brendshme, duke mos patur kontakt me të.

Operacioni Stuxnet, për shembull është një nga operacionet më të famshëm të luftës pa kontakt. Stuxnet ishte një sulm kibernetik i sofistikuar, i zhvilluar nga SHBA dhe Izraeli, me qëllim për të sabotuar programin bërthamor të Iranit, pa përdorur asnjë armë fizike dhe zjarri. Filloi rreth vitit 2007–2008 (fshehtësisht) dhe u zbulua nga ekspertët e sigurisë në qershor 2010. Qëllimi i sulmit ishte shkatërrimi i centrifugave në uzinën bërthamore iraniane të Natanz, të përdorura për pasurimin e uraniumit. Stuxnet infektonte sistemet kompjuterike industriale (SCADA të kontrolluara nga Siemens). Ky virus arriti të ndryshonte funksionimin e centrifugave, duke i bërë ato të punonin në mënyrë jo të qëndrueshme. Virusi shkaktoi dëmtime fizike, ndërsa tregonte të dhëna normale në ekranet e tyre për operatorët, në këtë mënyrë ata nuk e kuptonin sulmin. Stuxnet ishte virusi i parë në histori që shkaktoi dëme fizike përmes një sulmi digjital. Ai shënoi fillimin e epokës së luftës kibernetike si një mjet real dhe efektiv për konflikt ndërkombëtar. Pasojat për Iranin ishin të mëdha, duke arritur në dëmtimin e mbi 1,000 centrifugave (nga rreth 5,000 që Irani kishte në atë kohë). Si pasojë e operacionit u krijuan vonesa të ndjeshme në programin bërthamor, si dhe u kërkuar rritje e vigjilencës kibernetike në të gjithë vendet që kishin program bërthamor në zhvillim. Stuxnet ishte kaq kompleks, sa besohet të jetë

zhvilluar nga disa qindra ekspertë dhe ka zgjatur për disa vite me radhë. Ai nuk u përhap në internet, por fillimisht u fut përmes USB-ve të infektuara, pasi objektivi nuk ishte i lidhur me internetin.

NCW (Non Contact Wafare)

Vrasja e Qasem Soleimani është një tjetër operacion i Luftës Pa Kontakt dhe shembull klasik i operacionit të bazuar në inteligjencë dhe i ekzekutuar përmes luftës pa kontakt. Më 3 janar 2020, në Aeroportin Ndërkombëtar të Bagdadit, Irak, u ekzekutua me sulm ajror me dron MQ-9 "Reaper" Qasem Soleimani, komandant i Forcave Quds të Gardës Revolucionare Islamike të Iranit (IRGC). Operacioni i dërgoi një mesazh paralajmërues Iranit, pas sulmeve të mëparshme ndaj ambasadës amerikane në Bagdad dhe forcave amerikane.


Droni MQ-9 sulmoi me raketa "Hellfire", duke shkatërruar makinën ku ndodhej Soleimani dhe pjesëtarë të milicive aleate. Në operacion u përfshinë mbikëqyrje satelitore, elektronike dhe njerëzore (SIGINT + HUMINT). U përdor informacion në kohë reale për itinerarin e Soleimanit nga Siria në Irak, si dhe u bashkëpunua me inteligjencën lokale (Irakiane ose aleatë të SHBA-së). Operacioni ishte i miratuar drejtpërdrejt nga Presidenti i SHBA-ve, pas analizave të informacionit të agjencive të inteligjencës. Pasojat dhe jehona ndërkombëtare të këtij operacioni ishin të rëndësishme si dhe u minua besimi dhe ndikimi iranian në Irak dhe Siri.

Sulmin rus kundër tokës polake të 10 shtatorit 2025, ka shumë komponentë të "luftës pa kontakt". Elementi i parë është synimi i Rusisë të fshehtë gjurmët e drejtpërdrejta, pasi për këtë ka përdorur territorin e një aleati të saj satelit si Bjellorusia. Bjellorusia është de facto e kontrolluar nga Rusia në aspektin ushtarak: trupat, avionët, sistemet e radarëve rusë janë vendosur aty që nga viti 2022. Ajo lejon Rusinë të veprojë përtej kufijve të saj pa ekspozuar direkt territorin rus, ndaj ndëshkimeve ose kundërpërgjigjeve. Me Bjellorusinë si platformë për lëshimin e dronëve, Rusia shmang përgjegjësinë e drejtpërdrejtë përballë NATO-s, pasi nuk ka një "provë të fortë" që një sistem komandim-kontrolli rus, drejtoi sulmin nga territori i vet. Kjo është një teknikë klasike e shmangies së përgjegjësisë, që e lejon Rusinë të thotë: "Nuk jemi ne, mund të jetë Bjellorusia që ka vepruar vetë, ose ky është një gabim teknik". Dronët që kalojnë kufirin në mënyrë të sinkronizuar, dhe nga shumë drejtime gjatë natës dhe që hyjnë thellë në territor, testojnë limitet e NATO-s, por e pa kaluar "vijën e kuqe" të Nenit 5. Pas incidentit, Polonia nuk e ka kërkuar ende zyrtarisht aktivizimin e Nenit 4, që thotë "Palët do të konsultohen së bashku kur, sipas mendimit të cilitdo prej

tyre, integriteti territorial, pavarësia politike ose siguria e njëres prej tyre është e kërcënueshme". Deri në vitin 2024, Neni 4 i NATO-s është aktivizuar të paktën 8 herë, ku Turqia e ka kërkuar 4 herë; në 2003, në luftën në Irak, në 2012 nga Turqia pas rrëzimit të një avioni turk nga Siria, në 2015 nga përshkallëzimi në kufirin sirian dhe 2020 nga vrasja e ushtarëve turq në Idlib. Në 2014 është kërkuar nga Polonia, Lituania, Letonia dhe Estonia, kundër aneksimit të Krimesë nga Rusia. Në vitin 2022 aktivizimi i nenit 4 është kërkuar nga Bullgaria, Çekia, Estonia, Letonia, Polonia, Rumania dhe Sllovakia, për rrezikun e përbashkët nga fillimi i agresionit rus në Ukrainë dhe e fundit, kur është kërkuar aktivizimi i nenit 4 të NATO-s, është në vitin 2023 nga Polonia gjatë një incidenti ku një raketë ruse bie në territorin Polak.

Në Ballkan, aktualisht po përdoren disa elemente të "luftës pa kontakt" me armët 3I, duke përdorur mjetet informative, ekonomike, teknologjike dhe psikologjike për të ndikuar ose destabilizuar pa pasur një konflikt të drejtpërdrejtë. Investimet strategjike në infrastrukturë, energji apo media po përdoren si mjete ndikimi, përmes kredive me kushte të disfavorshme, që i lidh vendet e Ballkanit me interesat gjeopolitike të aktorëve të caktuar. Korrupsioni i strukturuar dhe i financuar nga jashtë, është një tjetër armë e luftës hibride dhe pa kontakt fizik ushtarak. Borxhet e larta ndaj investorëve kinezë në disa vende të Ballkanit po përdoren për ngritjen e bizneseve "të huaja" që përdoren për pastrim parash ose influencë politike. Hakerimi i të dhënave personale, destabilizim përmes rrjedhjes së informacionit, siç ndodhi në Shqipëri në vitin 2022 me sulmet e lidhura me Iranin është një shembull i kësaj lufte të re. Formë e kësaj, është lufta kulturore dhe ideologjike përmes përhapjes së një ideologjie të përzgjedhur përmes shkollave, organizatave fetare dhe OJQ-ve, veçanërisht në zonat me ndarje etnike (si në Bosnje, Kosovë, Maqedoni e Veriut). Media të kontrolluara nga aktorë të huaj po përhapin narrativa të përpunuara, për të polarizuar opinionin publik dhe rritur mosbesimin ndaj institucioneve. Fushata dezinformuese në rrjete sociale nxisin ndarje etnike, politike apo sociale, sidomos gjatë zgjedhjeve ose krizave. Përhapje teorish konspirative, që dëmtojnë strukturat demokratike ose promovojnë interesat e aktorëve si të Rusisë dhe Kinës, përmes mediave, instituteve kulturore apo burimeve të tjera. Këto fuqi po përdorin trolle në rrjetet sociale për të manipuluar diskursin publik. "Lufta pa kontakt" është një realitet në Ballkan, ndonëse jo e dukshme.

Shqipëria, si pjesë e kësaj hapësire të brishtë gjeopolitike, është gjithashtu edhe pjesë e kësaj "beteje të



heshtur”, me armët 3 I, ku influencat përplasen përmes informacionit, teknologjisë, parave dhe narrativave kulturore apo ideologjike. Në vend të armëve të zjarrit, nga kundërshtarët tanë, përdoren armët e ndikimit. Dhe në shumë raste, ato janë më efektive sesa lufta konvencionale. Ndikimi i huaj në zgjedhje, përmes mbështetjes së kandidatëve pro-rusë ose sabotimit të rivalëve pro-perëndimorë, po rritet në Bosnjë, Maqedoninë e Veriut, Mal të Zi dhe Kosovë. Vazhdimi i ofensivës së Rusisë në Ukrainë, mund t’i përballë aktorët e Ballkanit Perëndimor në të ardhmen, me destabilizime serioze, përfshirë Kosovën, Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Këto operacione janë më pak të kushtueshme, por dhe më efektive se format e tjera të luftës në rajonin tonë.

Trelateralja Shqipëri–Mal i Zi–Kosovë–Kroaci, është një hap i rëndësishëm kundërshtues i këtyre përpjekjeve. Marrëveshja e nënshkruar, më 18 mars 2025, doli me një deklaratë bashkëpunimi ushtarak, e cila përfshin luftën kundër kërcënimeve pa kontakt që shfaqet në format

kibernetike, të dezinformimit, etj. Iniciativa e vendeve tona, ka qëllim të harmonizojë politikën e jashtme të rajonit me atë të BE-së, si dhe për të forcuar rezistencën ndaj ndikimeve të jashtme. Bashkëpunimi BE–NATO është shumë i nevojshëm për të ndalur kërcënimet hibride në Ballkan që po intensifikohen, me fokus në inteligjencë, mbrojtje kibernetike dhe mbështetje institucionale. Simpoziumet për dezinformatat, si ai në Tiranë (2023), synojnë të forcojnë rezistencën e shoqërisë civile ndaj propagandës dhe mashtrimeve që ka gjasa të vazhdojnë gjatë.

Analiza e mësipërme nuk do të thotë që lufta tradicionale do të zhduket plotësisht. Në raste të caktuara, pushtimi fizik apo prania ushtarake mund të jetë e domosdoshme. Por këto operacione do të jenë gjithnjë e më të rralla dhe të ndërthurura me operacione pa kontakt. Nëse trendet aktuale vazhdojnë në këtë mënyrë dhe intensitet, lufta pa kontakt jo vetëm që do të rritet, por do të bëhet forma dominante e konfrontimit ndërkombëtar në dekadat që vijnë.

UNIFORMA, SIMBOLET dhe armatimi, *identiteti i Forcave të Armatosura*

Uniforma, pasqyra e disiplinës dhe përkatësisë

Uniforma ushtarake është elementi i parë që bie në sy te çdo efektiv i Forcave të Armatosura. Ajo nuk është vetëm një veshje pune, por një simbol i disiplinës, përkushtimit dhe respektit ndaj misionit. Uniforma shqiptare ka kaluar disa faza zhvillimi gjatë viteve, duke u përshtatur me kohën, misionet dhe standardet e NATO-s, ku vendi ynë bën pjesë.

Uniforma përbën edhe një element të rëndësishëm identifikimi për qytetarët: kur shohin ushtarin e veshur me uniformë, ata shohin përfaqësuesin e shtetit, të sigurisë dhe të rendit. Për efektivet, mbajtja e saj është një nder dhe përgjegjësi, sepse çdo ditë përfaqësojnë Ushtrinë Shqiptare në publik.

Simbolet që bartin histori dhe traditë

Në çdo pjesë të uniformës vendosen simbolet që tregojnë përkatësinë dhe traditën. Stema e Forcave të Armatosura, shqiponja dykrenare, ngjyrat e flamurit dhe elementë të tjerë të identitetit kombëtar janë pjesë e pandashme e uniformës.

Simbolet e mbajtura mbi uniformë lidhen ngushtë me historinë e ushtrisë sonë, duke nisur nga periudha e Luftës Nacionalçlirimtare, e deri tek Ushtria moderne e shekullit XXI. Ato janë një urë lidhëse mes brezave të ushtarakëve, duke kujtuar gjithmonë sakrificat dhe kontributin e atyre që shërbyen më parë.

Batalioni Komando Policia Ushtarake

Një element i veçantë në uniformë janë shenjat dalluese, të cilat përcaktojnë gradën, funksionin dhe repartin e çdo ushtari. Nga njëri efektiv te tjetri, shenjat tregojnë hierarkinë, duke siguruar rend, disiplinë dhe

respekt për strukturën komanduese.

Shenjat dalluese nuk janë vetëm simbole hierarkike, por edhe profesionale. Për shembull, efektivet që i përkasin forcave tokësore, ajrore apo detare mbajnë simbole të ndryshme dalluese. Po ashtu, uniforma e mjekëve ushtarakë, e trupave speciale apo e policisë ushtarake ka shenja unike që e identifikojnë qartë rolin e tyre.

Armatimi, garanci për mbrojtjen dhe sigurinë

Ashtu si uniforma dhe simbolet, edhe armatimi është një pjesë e pandashme e portretit të ushtrisë. Forcat e Armatosura shqiptare janë të pajisura me armë dhe mjete që i përgjigjen nevojave moderne, duke siguruar aftësi të plota për mbrojtjen e vendit dhe për misionet ndërkombëtare.

Armatimi përbën një element sigurie dhe përgjegjësie. Çdo efektiv trajnohet për ta përdorur me profesionalizëm, duke respektuar rregullat e sigurisë dhe misionin e tyre. Nga pajisjet individuale të lehta deri tek mjetet e rënda dhe teknologjitë e avancuara, armatimi është garancia që ushtria të jetë gjithmonë gati.

Identiteti i përbashkët i Forcave të Armatosura

Uniforma, simbolet, shenjat dalluese dhe armatimi, të marra së bashku, përfaqësojnë identitetin e plotë të Forcave të Armatosura. Ato janë elementët që bëjnë dallimin mes një individi të thjeshtë dhe një ushtari në shërbim të kombit. Për ushtarin shqiptar, këto nuk janë vetëm mjete pune apo shenja formale. Ato përfaqësojnë nderin e të shërbyerit nën flamurin kuqez, disiplinën e përditshme dhe përkushtimin ndaj sigurisë së qytetarëve dhe sovranitetit të vendit.



**Shenja krahëse
kombëtare**



**Shtabi i
Përgjithshëm**



**Forca
Tokësore**



**Forca
Ajrore**



**Forca
Detare**



**Akademia
e FA**



**Komanda
Mbështetëse**



**Batalioni i
Forcave Speciale**



**Batalioni
Komando**



**Policia
Ushtarake**

GJAKU U BË FJALË, fjala u bë këngë, TANI RADHA ËSHTË E JONA...

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Si mund të heshtësh?!

Ka vargje që nuk i lexon, por i ndien si therje në shpirt. Janë ato fjalë që të zgjojnë kujtesën e gjakut, të kujtojnë se kush je, pse je dhe pse nuk mund të heshtësh.

Këtu nuk ka vend për metafora të buta. Këtu flitet për gjak, për shkronja, për këngë, tre elementë që, kur bashkohen, japin kuptimin e pavdekësisë së një kombi.

Gjaku që s'u tret, por u bë fjalë...

Historia shqiptare është e mbushur me plagë. Por ajo që e bën të pazakontë është se plagët nuk u lanë të mbyllen në harresë. Gjaku nuk u la të thahej, pa shënjuar histori, ai u mbledh dhe u kthye në fjalë, në poezi, në këngë.

Ky është një akt i jashtëzakonshëm i kujtesës kombëtare, të mos harrosh, por të shndërrosh dhimbjen në forcë dhe në identitet.

Një komb që ringjallet nga rrënojat

"Bota që kur është zënë, Shqipëria gjallë ka qenë", deklaratë që tejkalon historinë e dokumentuar, historia jonë e dëshmon sa herë është menduar se Shqipëria u shua, ajo është ringjallur. Nga pushtimet, nga copëtimet, nga heshtja. Ajo ka lindur sërish, sepse rrënjët e saj janë në gjak, jo në letra diplomatike.

Nga gjaku në këngë, pavdekësia e shpirtit shqiptar...

Nëse kombet maten nga aftësia për të luftuar, shqiptarët kanë luftuar jo më pak se kombet e tjerë. Por nëse kombet maten nga aftësia për të kënduar dhimbjen dhe për ta kthyer atë në art, shqiptarët janë unikë. Lahuta e malësorëve, vajtimet e grave shqiptare, vargjet e rilindësve të gjitha janë dëshmi se ky popull nuk e la dhimbjen të mbytet në heshtje, por e shndërroi në trashëgimi.

Kënga ka qenë arma jonë e dytë, pas pushkës. Dhe shpesh, më e fortë se pushka. Sepse armët mbarojnë,



kufijtë ndryshojnë, por kënga mbetet, udhëton brez pas brezi, ringjall ndjenjën e përbashkët dhe e bën Shqipërinë të përhershme. Në një kohë kur globalizmi i zhduk ngjyrat kombëtare, kënga jonë është alarmi që na paralajmëron: kujdes, mos harroni kush jeni!

Shqipëria nuk ka moshë...

Shqipëria, nuk është thjesht një vend i vogël në hartë. Ajo është si një ide universale, një frymë që ka lindur bashkë me botën. Shqipëria nuk ka moshë. Ajo lindi qysh kur mbi tokë lindi njerëzimi, dhe kjo është e shkruar jo veç në copa letrash, por në vetë ekzistencën e popullit që e mban gjallë.

Nëse duam të meritojmë këtë trashëgimi, le të japim secili sot pjesën tonë, që gjaku i të rënëve të mos kthehet në harresë, por të mbetet përjetësisht këngë. Historia shqiptare është një kalvar plagësh, pushtime, copëtime kufijsh, tradhti diplomatike. Por ajo që e bën Shqipërinë të jashtëzakonshme është fakti se plagët nuk u lanë të mbyllen në heshtje. Gjaku i derdhur nga të parët nuk u shpërdorua, ai u mblodh, u shkrua dhe u këndua, duke u bërë trashëgimi e përjetshme dhe forcë e identitetit tonë kombëtar.

Çdo këngë kreshnike, çdo vajtim popullor nuk është thjesht art, është një akt kujtese dhe rezistence. Shqiptarët nuk kanë lejuar që dhimbja të shndërrohet në gjurmë të fikura. Përkundrazi, e kanë kthyer dhimbjen në forcë. Ky shndërrim i humbjes në këngë, i tragjedisë në identitet, është një fenomen i rrallë kulturor, garancia e pavdekësisë sonë. Një popull që di të këndojë mbi gjakun e tij nuk mund të zhduket.

Këto vargje nuk janë thjesht poezi, ato janë një testament, një thirrje që na kujton se nuk mund të heshtim. Heshtja është vrasja e dytë e Shqipërisë, më e rrezikshme se çdo pushtim.

Gjaku u bë fjalë, fjala u bë këngë, kënga u bë Shqipëri

Tani është radha jonë: këndimin ta kthejmë në veprë. Vetëm kështu do ta mbajmë Shqipërinë të përjetshme, të gjallë që nga zanafilla e botës.

Shqipëri... gjaku në vena thërret!

Në damarët tanë nuk rrjedh vetëm gjak, por histori. Çdo rrahje zemre është një kujtesë e gjallë e sakrificave të brezave që derdhën jetën për këtë tokë. Sot, kur shumë të

rinj e shohin shpëtimin te një biletë avioni, thirrja e gjakut bëhet edhe më e fuqishme: mos e braktis Shqipërinë, sepse ajo jeton vetëm përmes jush.

Rinia, ura e Shqipërisë drejt Europës

Në një kohë kur Shqipëria po afrohet gjithnjë e më shumë me Bashkimin Europian, po hapen edhe mundësi të reja. Të rinjtë shqiptarë mund të mësojnë, punojnë e fitojnë përvojë jashtë, por gjithnjë me mundësinë për t'u kthyer e për të sjellë këtu dijen, kulturën dhe përvojën që fitojnë. Shqipëria nuk është vetëm një kujtim, por një vend që po ecën drejt së ardhmes. Ajo ka nevojë për rininë e saj për ëndrrat, energjinë dhe guximin që ta mbajë gjallë dhe ta bëjë më të fortë.

Gjaku i derdhur kërkon përgjigje...

Gjaku i të rënëve nuk u tret, ai u shndërrua në fjalë dhe këngë që përçojnë kujtesën dhe krenarinë kombëtare. Por sot, çfarë ndodh kur kënga mbetet e mbyllur në libra, ndërsa të rinjtë largohen pa kthim?

Gjaku i derdhur për këtë tokë nuk kërkon lavdi të shkuar, ai kërkon përgjigje në të tashmen. Dhe përgjigjja është e thjeshtë, por thelbësore qëndrim, ndërtim, përkushtim. Vetëm kështu mund të mbajmë gjallë historinë, identitetin dhe shpirtin e Shqipërisë.

Rreziku i heshtjes...

Armiku më i madh i një kombi nuk është gjithmonë i huaji, por heshtja e bijve të vet. Sot, rreziku nuk vjen nga pushtimet, por nga braktisja e heshtur.

Kur një i ri largohet pa kthim, nuk humbet vetëm një individ, por një copë e së ardhmes së vendit. Dhe nëse ky proces vazhdon, atëherë kënga jonë kombëtare rrezikon të mbetet jehonë pa zë. Mos e shihni Shqipërinë si barrë. Shikojeni si sfidë, si fushë të pashkelur ku mund të lini gjurmë. Kombi nuk jeton vetëm me kujtime, por me vepra. Dhe veprat nuk do t'i bëjë askush tjetër për ne, as Europa, as Amerika. Veprat e Shqipërisë do t'i bëjmë vetëm ne, ose nuk do të bëhen kurrë.

Thirrja e gjakut

Shqipëria nuk ka moshë. Ajo jeton aq sa jeton në venat tona. Dhe venat e sotme janë venat e rinisë shqiptare. Nëse ato thahen larg atdheut, Shqipëria mbetet pa gjak.

Prandaj, mos harroni, gjaku në vena thërret. Ai nuk ju thërret për nostalgji, por për përgjegjësi. Shqipëria jeton vetëm nëse ju e mbani gjallë.

Barazia që vonon: Gruaja shqiptare në betejë me stereotipat

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

‘Gjysma e shoqërisë që nuk pranon më të heshtë’

Historia e shoqërisë shqiptare është një histori e ndërtuar mbi kontradikta të mëdha: nga njëra anë, një traditë e gjatë e shoqërisë patriarkale, ku figura e burrit ka mbizotëruar në sferën publike dhe vendimmarrëse; nga ana tjetër, qëndresa e gruas, e cila ka mbajtur mbi supet e saj barrën e familjes, të moralit dhe shpeshherë edhe të vetë mbijetesës së kombit. Sot, në një kohë tranzicioni të gjatë kulturor e shoqëror, gruaja shqiptare përballet ende me “unin maskilist”, një strukturë të ngulitur thellë në mentalitet, në raportet shoqërore, madje edhe në vetë institucionet.

Dimensioni historik: femra mes nënshtrimit dhe qëndresës

Në traditën shqiptare, e mishëruar për shekuj në Kanunin e Lekë Dukagjinit dhe rregullat e zakonshme të jetës fshatare e qytetare, gruaja është parë shpesh si “pjesë e shtëpisë”, e kufizuar në rolin e nënës, amvisës dhe kujdestares. Burrëria, nderi dhe vendimmarrja i takonin burrit. Në shumë raste, gruaja nuk kishte të drejtë të trashëgonte, të fliste në kuvend apo të merrte pjesë në jetën publike.

Megjithatë, ky rrëfim historik nuk është i plotë pa theksuar rolin e grave që e thyen heshtjen.

Nga heroinat e historisë, si Nora e Kelmendit apo Shotë Galica, te nënat e varfra që rriten fëmijë në kushte të pamundura, gruaja shqiptare ka dëshmuar se përtej kufizimeve patriarkale, ajo ka qenë një faktor vendimtar në mbijetesën dhe formësimin e identitetit tonë kolektiv.

Uni maskilist si strukturë kulturore dhe psikologjike

“Uni” maskilist nuk është vetëm një qëndrim individual, por një ndërtim kulturor që shfaqet në shumë nivele: Në gjuhë dhe komunikim: fraza të zakonshme si “burrat janë kryefamiljarë”, “gratë nuk kuptojnë politikën”, ose “vajza është mysafire në shtëpinë e babait” e përforcojnë idenë e hierarkisë gjinore.

Në familje: shpesh vendimet madhore, që nga arsimimi i fëmijëve deri te menaxhimi i të ardhurave, mbeten të përqendruara tek figura mashkullore.

Në shoqëri: pjesëmarrja e grave në politikë apo ekonomi shpesh perceptohet si përjashtim, jo si normë, dhe shpeshherë paragjykohet.

Ky “un maskilist” ka rrënjë në frikën nga humbja e pushtetit: emancipimi i gruas shihet si rrezik për rolin dominues të burrit.

Në fakt, është një betejë simbolike mes së vjetrës dhe së resë, ku gruaja shihet ende si “tjetra”, jo si bashkëpjesëmarrëse e barabartë.

Gruaja në tranzicion: përballja me sfidat moderne

Në Shqipëri dhe trojet shqiptare, tranzicioni post-komunist solli liri të reja, por edhe pasiguri të thella. Për gratë, kjo periudhë u shoqërua me: Migrimin masiv, ku shumë gra mbetën të vetme, duke mbajtur mbi vete familjen ndërsa burrat punonin jashtë.

Ekonominë e pasigurt, ku mungesa e vendeve të punës i shtyu gratë drejt tregut informal, shpesh pa siguri sociale.

Dhuna në familje: një nga plagët më të rënda të shoqërisë shqiptare, që ende sot kërkon një adresim serioz institucional.

Arsimin dhe punësimin, megjithëse më shumë vajza



diplomohen sot në universitete se djem, tregu i punës dhe hierarkitë institucionale nuk reflektojnë ende barazi reale.

Perspektiva sociologjike dhe feministe

Analizat feministe mbi shoqërinë shqiptare theksojnë se barazia gjinore nuk është thjesht një çështje ligjore edhe pse ligjet janë përmirësuar ndjeshëm. Ajo është një proces i gjatë ndryshimi kulturor. "Uni" maskilist shfaqet edhe në mënyra të fshehta, përmes stereotipave, përmes roleve të paracaktuara dhe përmes një shoqërie që shpesh e mat vlerën e gruas nga lidhja e saj me burrin, jo nga individi. Në këtë kontekst, emancipimi i gruas shqiptare nuk është thjesht një betejë e saj personale, por një sfidë e gjithë shoqërisë. Pa barazi gjinore nuk mund të ketë zhvillim demokratik, nuk mund të ketë drejtësi sociale, nuk mund të ketë progres.

Gruaja si aktore e re në jetën sociale

Sot, gjithnjë e më shumë, gratë po thyjnë tabutë dhe po marrin rolin që u takon, në akademi, në media, në politikë, në biznes. Ato nuk janë më vetëm bartëse të traditës, por krijuese të së ardhmes. Një brez i ri po kërkon hapësira më të gjera, duke e parë barazinë jo si privilegj, por si të drejtë themelore. Megjithatë, sfida mbetet e hapur, sa e gatshme është shoqëria shqiptare të heqë dorë nga "uni maskilist"? A është i gatshëm burri shqiptar të shohë në gruan jo një rivale, por një partnere të barabartë?

Statistika mbi pjesëmarrjen në politikë dhe përfaqësim gjinor

- Pas zgjedhjeve të 25 qershorit 2025, parlamenti i Shqipërisë përbëhet nga 39 deputete gra nga gjithsej

140 mandate. Kjo është rreth 27.85% përqindje dhe është numri më i lartë që prej vitit 1992, që kur vendi nisi sistemin pluralist.

- Në listat e kandidatëve për deputetë në këto zgjedhje, rreth 39.93% të kandidatëve ishin gra.

Kuotat gjinore në ligjin shqiptar për zgjedhjet përcaktojnë që të paktën 30% e kandidatëve në listat zgjedhore të jenë gra. Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar që këto kuota janë në përputhje me Kushtetutën.

Statistika ekonomike dhe përfshirje në punë / sipërmarrje

- Sipas INSTAT, 31.4% e ndërmarrjeve ekonomike aktive (pa përfshirë fermerët) janë në pronësi ose drejtohen prej grave.

- Gratë janë më të përfaqësuara në sektorët e shërbimeve (ku rreth 40.9%) dhe në tregti (rreth 33.9%) ndër ndërmarrjet që drejtohen ose janë në pronësi grash. Por ato janë shumë më pak në sektorin e ndërtimit, vetëm rreth 16.1%.

- Sipas një raporti të vitit të kaluar, pjesëmarrja e grave në forcën punëtore (mosha 15-64) është afër 58.9%, krahasuar me burrat që është rreth 71.3%. Kjo tregon një hendek të vazhdueshëm midis burrave dhe grave në punësim.

Pengesat e identifikuar

Nga statistikat dhe analizat e ekspertëve, këto janë disa nga pengesat kryesore që dalin:


- Gratë shpesh kanë më pak burime për fushata elektorale, më pak kontakte e rrjete që mund t'i ndihmojnë për mbledhje fondesh.

- Stereotipa dhe mentalitete kulturore. Kërkesat shoqërore, pritshmëritë familjare, roli tradicional familjar, si dhe paragjykimet janë barrierë reale për gratë që duan të jenë në sipërfaqe publike dhe vendimmarrëse. (Këto nuk janë gjithmonë të matshme lehtë me statistika, por evidentohen nga analizat shoqërore dhe raportet e organizatave që merren me barazi gjinore.)

- Pabarazitë ekonomike. Dallimet në paga, punë informale me siguri të ulët, mungesë pensioni ose sigurime shoqërore në sektorët ku punojnë shumë gra etj. Këto kufizojnë mundësinë për të zgjedhur të jenë aktive politike, sepse shpesh përballen me nevojë më prioritare ekonomike.

Gruaja shqiptare është përballë një paradoksi të madh, nga njëra anë, ajo ka fituar hapësira të reja, arsimim dhe pjesëmarrje, nga ana tjetër, mbetet nën hijen e një kulture maskiliste që shpesh i mohon barazinë reale.

Por historia ka treguar se ajo nuk është dorëzuar asnjëherë. Përballë unit maskilist, gruaja shqiptare po ndërton dalëngadalë një "un" të ri: një identitet që përfshin të drejtën për të qenë vetvetja, për të ndërtuar dhe për të udhëhequr. Ky proces nuk është i lehtë dhe nuk është i shpejtë. Por është i pashmangshëm. Sepse një shoqëri që mohon gjysmën e vet, mohon vetë të ardhmen.



Nga Tradita në Modernitet

68 Vjet Shërbimi Hidrografik Shqiptar



Më 25 shtator 1957, u themelua Shërbimi Hidrografik Shqiptar (SHHSH), si domosdoshmëri për sigurimin hidro-lundrimor të anijeve në ujërat tona territoriale. Sot, 67 vjet më pas, ky institucion mbetet themel i sigurisë detare dhe zhvillimit të infrastrukturës blu të vendit.

Nderim dhe mirënjohje i shkojnë personelit të parë, që me përkushtim hodhi bazat e këtij shërbimi:

- Komandant, Kapiten i Rangut II, Arqile Papadhimitri,
- Zëvendëskomandant, Kapiten i Rangut III, Kiço Lati,
- Shef i Hidrografisë, Kapiten i Rangut III, Mersin Shqypi,
- Shef i sinjalistikës detare, Kapiten Teufik Digli,



- Shef i sinoptikës, Kapiten Seit Berisha.

Tradita hidrografike në Shqipëri shënohet që në fund të shek. XIX, kur specialistë austro-hungarezë dhe më pas italianë realizuan hartat e para detare dhe vendosën faro-fenerët e parë në bregdetin tonë. Në vijim, specialistët shqiptarë krijuan hartat e para zyrtare “paper charts”, duke aplikuar standardet e Organizatës Ndërkombëtare Hidrografike (IHO).

Nga tradita në modernitet

Hidrografia dhe hartografimi detar sot janë të pandashme nga zhvillimi i ekonomisë blu dhe menaxhimi i burimeve mbi e nënujore. Anëtarësimi i Shqipërisë në:

- Organizatën Ndërkombëtare të Hidrografisë (IHO),
 - Organizatën Ndërkombëtare të Ndihmës në Lundrim (IALA), si dhe në
 - Komisionin Hidrografik të Detit Mesdhe dhe Detit të Zi (MBSHC),
- e ka bërë vendin tonë pjesë të forumit ndërkombëtar

ku merren vendime për sigurinë lundrimore, kufijtë detarë dhe standardet hidrografike.

Këto anëtarësime sollën përfitime të rëndësishme:

- Trajtime dhe kualifikime falas për specialistët shqiptarë,
- Rritje të kapaciteteve teknike dhe operacionale,
- Pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare,
- Përfshirje në bashkëpunime rajonale për matje batimetrike, hartografi dhe sinjalistikë detare.

Sfida dhe prioritetet

Sot SHHSH ka një rol të pazëvendësueshëm për sigurinë e tregtisë detare dhe lundrimit në Adriatik e Jon. Hartat, udhëzuesit e lundrimit, listat e fenerëve dhe botimet e tjera detare janë garanci për shmanjen e fatkeqësive në det.

Prioritetet e punës në vijim mbeten:

1. Përpilimi dhe publikimi i hartave të reja detare (letër & elektronike).
2. Modernizimi i sinjalistikës detare, me instalimin e fenerëve të rinj.
3. Pjesëmarrja në konferenca dhe seminare ndërkombëtare për rritjen e kapaciteteve.
4. Forcimi i bashkëpunimit me IHO, IALA dhe MBSHC.
5. Krijimi i bazës ligjore të posaçme për funksionimin dhe shërbimet e SHHSH.

Një det i sigurt, një ekonomi e fortë

Shërbimi Hidrografik Shqiptar, në bashkëpunim me Forcën Detare dhe partnerët ndërkombëtarë, do të vijojë misionin e tij fisnik: sigurimin e një lundrimi të sigurt, mbrojtjen e mjedisit detar dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurive që ofron deti. Deti është e ardhmja jonë dhe SHHSH mbetet garant i sigurisë dhe zhvillimit të tij.

”Big Band”



ORKESTRA SIMFONIKE E FORCAVE TË ARMATOSURA

“N D E Z”

AMFITEATRIN E LIQENIT

Në një mbrëmje të mbushur me emocion, art dhe atmosferë festive, amfiteatri i Liqenit Artificial të Tiranës u kthye në një skenë të gjallë ku muzika dhe qyteti u bashkuan në një festë të paharrueshme. Me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit Tiranë, “Big Band” e Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhuroi një performancë të jashtëzakonshme, duke dëshmuar se arti ushtarak mbetet një vlerë e çmuar për jetën kulturore të vendit.

“Big Band” solli një repertor të pasur, ku u ndërthurën tingujt e jazz-it klasik me motive shqiptare dhe kompozime ndërkombëtare. Çdo pjesë muzikore ishte një rrëfim më vete, një udhëtim përmes emocioneve që ngrinin zemrat e publikut në të njëjtin ritëm me orkestrën. Publiku kryeqytetas, i mbledhur në numër të madh e përjetoi koncertin si një festë të vërtetë qytetare. Duartrokitjet e gjata, buzëqeshjet e ndritshme dhe vallëzimet spontane krijuan një lidhje të gjallë mes skenës dhe spektatorëve, duke dëshmuar edhe një herë forcën bashkuese të muzikës.

Mbrëmja artistike ishte më shumë se një koncert, ishte një shembull i harmonisë së bukur mes artit, qytetit dhe shërbimit publik. Përmes tingujve të orkestrës, Forcat e Armatosura përcollën një mesazh të qartë: janë pranë qytetarëve jo vetëm në ditë sfidash, por edhe në momente gëzimi, reflektimi dhe frymëzimi kulturor. “Big Band” e Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, dëshmoi se uniforma mund të mbajë në vetvete jo vetëm disiplinën dhe forcën, por edhe artin, emocionin dhe shpirtin e kombit.

Në fund të mbrëmjes, nën dritat që pasqyroheshin në sipërfaqen e liqenit, muzika u bë frymë, dhe fryma u bë festë. Falë “Big Band” dhe përkushtimit të Orkestrës Simfonike të Forcave të Armatosura, Tirana jetoi një natë që do të mbetet gjatë në kujtesën e saj, një simfoni e vërtetë në zemrën e qytetit.





Lufta e Arbanës



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Fshati Arbanë, bazë e luftës

Arbana, në kohën e LANÇ-it, ishte një nga bazat kryesore të Grupit të Pezës. Në luginën e Erzenit, afër Arbanës, ditët e para të tetorit të vitit 1943, po grumbulloheshin forcat, të cilat do të formonin Brigadën III Sulmuese (BrIIS). Ndërsa tre batalione të Grupit të Pezës, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm kishin zënë pozicione në kodrat përballë Petrelës, Tiranës dhe Vaqarrit, duke krijuar kështu një gjysmërreth dhe për të mbrojtur drejtimet e lëvizjeve të mundshme të armiqeve.

Batalioni i tretë vendoset në pozicione në kodrat e Saukut, batalioni i dytë vendoset në pozicione në rrugën Tiranë-Elbasan, batalioni i parë vëzhgonte rrugën Tiranë-Ndroq, tek ura e Beshirit, dhe batalioni i katërt kontrollonte një rrugore kyç të Vorës. Forcat partizane bëheshin afërsisht në këtë zonë rreth 1.000 luftëtarë. Ndërsa në zonën e Vorës do të hynin në veprim edhe partizanë të batalionit “Krujë-Ishëm”, kurse në rrugën Tiranë-Elbasan, si vijë kryesore e lëvizjes së trupave hitleriane, do të jepnin goditje forcat e BrIS dhe partizanë të batalionit “Dajti”. Zënia e këtyre pikave, afrimi i forcave partizane të Dibrës në Krujë, dalja e BrIS në Kërrabë, grumbullimi i forcave partizane për krijimin e BrIIS në Arbanë dhe të BrIIS në Shëngjergj, të gjitha këto forca u përqendruan sipas planit strategjik të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së. Në Arbanë ndodhej dhe Komanda e Shtabit të Përgjithshëm, për të ndjekur nga afër gjendjen e krijuar, e duke marrë pjesë në organizimin e BrIIS. Në zonën e Pezës në Alltat, një katund i vogël rreth një orë larg Arbanës ishte vendqëndrimi i Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH-së.

Befasia e operacionit gjerman

Rajoni që zgjodhi komanda naziste për këtë operacion të rrufeshëm ishte lugina e Erzenit përreth fshatit Arbanë. Komanda e Korpusit XXI gjerman angazhoi në këtë operacion dy batalione me rreth 2.000 ushtarë dhe një kompani xheniere. Suksesi i operacionit ajo e mbështeti tek befasia. Vrojtues dhe zbulues të forcave të armikut kishin të dhëna të mjaftueshme për vendosje dhe lëvizje të partizanëve në zonë. Ditë më parë një nënrepart armik kishte hyrë në zonë afër Arbanës për zbulimin e pozicioneve të partizanëve. Ndërsa një nënrepart bëri përpjekje nga ura e Beshirit, por nuk përparoi se u sulmua dhe u largua me shpejtësi. Më 8 tetor, komanda gjermane urdhëroi fillimin e operacionit.

Ndërsa komanda e forcave partizane s'dinte gjë të saktë për operacionin. Dy batalionet gjermane, të urdhëruar për të kryer operacion, mbërritën në

fshehtësi në afërsi të Arbanës. Luftimet nisën në mëngjesin e 9 tetorit. Nënrepartet pararojë të armikut u ndeshën në zjarrin e forcave partizane në afërsi të Arbanës. Armikutë filluan të qëllonin mbi Arbanë dhe në kodrat përreth me artileri dhe mortaja. Ndërkohë futi në luftim dhe tanket e lehta.

Forcat naziste u përpoqën të shfrytëzonin përparësinë e befasisë dhe shpresonin të kapnin Arbanën, dhe të shpartallonin partizanët. Nazistët mendonin se partizanët nuk kishin kohë e mundësi të organizonin një qëndresë. Komandanti i batalionit nazist pjesëmarrës në këtë luftim do të shkruante se “qëllimi për të goditur armikun në befasi u arrit. Tani gjithë puna qëndronte të shfrytëzohej përparësia e fituar, duke iu qepur pas kundërshtarit për të mos e lënë të ikte, por të detyrohej të luftonte e të asgjësohej. Mirëpo ndodhi krejt ndryshe...”. Nazistët menduan se në Arbanë i kishin partizanët brenda një dare, që nuk do të shpëtonin, por shfrytëzimi me mjeshtëri i terrenit dhe shpejtësia në kryerjen e veprimeve luftarake nga ana e luftëtarëve, bëri që gjermanët të binin në kurth. Batalioni i parë i Grupit partizan të Pezës, u ndesh me forcat armike. Në pamundësi për të ndaluar mësymjen e forcave naziste të shoqëruara nga tanket, batalioni u tërhoq dhe zuri pozicione në lartësitë e kodrave dhe nuk e la armikun të përparonte.

Partizanët mbyllën të gjitha shtigjet

Komanda e Shtabit të Përgjithshëm mori menjëherë në dorë drejtimin e luftimeve. Komanda përpunoi me të shpejtë planin e veprimeve luftarake, në bazë të rrethanave të krijuara, duke u vënë detyrë forcave partizane të ndalohej çdo tërheqje jashtë zonës së luftimeve, të mbaheshin me çdo kusht kodrat përreth luginës së Erzenit, t'i mbylleshin armikut të gjitha shtigjet e daljes nga lugina dhe të asgjësohej ai me zjarr e me kundërsulme. Në sektorin e luftimeve mbërritën dhe forcat e BrIIS, të cilat së bashku me forcat e batalionit të parë të Grupit të Pezës luftuan kundër forcave naziste që sulmonin

gjatë bregut të lumit Erzen, afër Arbanës. Ndërsa artileria e BrllIS u vendos në pozicione zjarri në kodrat e Arbanës dhe që andej me qitje direkte qëllonte tanket armike. “Dreqi e marrtë këtë punë, - do të shkruante në ditarin e vet komandanti i batalionit gjerman, - më duket, ne paskemi rënë në një grackë të vërtetë. Lugina formuaka një kazan dhe ne ndodhemi në fund të tij. Nga pas lugina është e mbyllur krejt prej maleve. Para nesh luginën e mbyll armiku dhe nga faqet e maleve godet krahët tona prej lart-poshtë”. Megjithatë gjermanët kishin shpresë se do të mund të dilnin nga kjo grackë dhe bënë përpjekje për t’u bërë ballë sulmeve të partizanëve. Luftime të ashpra, deri edhe trup me trup, zhvilloheshin në zonë, afër përroit të Zhullimës, te mulliri i Arbanës ku luftonin forcat e BrllIS. Sulmi i forcave partizane nën komandën e Kajo Karafilit nga Sauku e Picalla në shpinë të trupave gjermane ishte një manovrim në kohë, që i befaso i armiqtë e i detyroi të tërhiqen.

Armiqu të shpresonin shumë te tanket dhe autobлиндat që qëllonin me zjarr të dendur krahët e partizanëve. Afër perëndimit të diellit, partizanët dhanë goditjen përfundimtare që e shpartalloi krejt armikun. Përsëri në ditarin e vet komandanti i batalionit gjerman shkruante se “prej rrjedhjes së ujit, dolën hije trupash që na afrohen dalëngadalë; partizanët po na sulmojnë gjatë Erzenit. Dëgjohet një zë paralajmërues... Toka nën këmbë sikur po zien, ajri po dridhet, njerëzit me mundim marrin frymë. Gjendja paraqitet pa shpresë. Armiku ka marrë përforsime të tjera. Tani gjithë puna është të qëndrojmë sa të erret, sepse nuk është e mundur të bëhet shkëputja prej armikut me ditë... Por edhe po të presim sa të erret, ekziston mundësia tjetër, që armiku të na rrethojë plotësisht. Pra e kemi keq nga të dyja anët... Sot duket sikur dielli ka vendosur të mos perëndojë kurrë...”.

Morali i luftëtarëve

Fitoren e luftës së Arbanës e vendosi morali i luftëtarëve dhe i popullit të zonës. Rol të madh për arritjen e suksesit në luftën e Arbanës pati dhe drejtimi i Shtabit të Përgjithshëm, ku në një gjendje tepër kritike për luftëtarët, që u krijua nga befasia e goditjes armike, forcat partizane të komanduara prej tij, ditën të ruajnë rregullin e organizimin e reparteve dhe brenda një kohe të shkurtër të kalojnë nga mbrojtja në mësymje, duke ia

rrëmbyer armikut iniciativën e veprimeve.

Trupat gjermane dështuan plotësisht në orvatjen e tyre për të asgjësuar forcat partizane dhe nga sulmues u kthyen të sulmuar, nga rrethues u shndërruan të rrethuar. Me manovrimet e lëvizjeve të shpejta, duke shfrytëzuar me zotësi terrenin, partizanët ia mbyllën shtigjet kryesore kundërshtarit dhe e vunë atë në një rrethim pa rrugëdalje. Shumica e mortajave dhe e mitralozave të rëndë të armikut dolën shpejt jashtë përdorimit, sepse u kapën ose u shkatërruan nga forcat kryengritëse. Por edhe artileria gjermane që mbështeste trupat vepruese pothuajse u neutralizua. Vijat e luftimit ndërmjet partizanëve dhe nazistëve ishin të papërcaktuara, sepse në disa pjesë të frontit këto vija ishin të pleksura me njëra-tjetrën. Çdo predhë e artilerisë armike në këto rrethana mund të dëmtonte njësoj si forcat çlirimtare ashtu edhe ushtarët nazistë. Kjo e detyronte komandën e artilerisë gjermane të mos qëllonte dot në shenjë në fushën e betejës, por t’i hidhte predhat më tepër në objektiva të papërcaktuar.

Nga luftimet në Arbanë komanda e Grupit të Pezës dhe BrllIS, nxorën mësim për të ardhmen, duke përfshirë këtu edhe mësimin si të mos zihej herë tjetër në befasi. Pas luftës së Arbanës gjendja në zonat e Shqipërisë së Mesme mbetej njësoj kërcënuese për armiqtë. Komanda e lartë gjermane dha urdhër kategorik të mos lëvizte asnjë automjet natën gjatë rrugëve që lidhnin kryeqytetin me Durrësin, Elbasanin dhe Strugën, kurse ditën autokolonat të lëviznin me masa të forta sigurimi. Nga ana e tyre, gjermanët pohuan se operacioni në rajonin e Arbanës “kishte dështuar plotësisht”. Komanda e Korpusit XXI ishte tepër e shqetësuar. Zhgënjimi i komandës ishte tepër i madh, sepse sipas informacioneve duhet të kishin përballë një “armik të dobët”, kurse kishte dalë që “armiku” paskësh qenë “i fortë”. Por, megjithëse trupat gjermane lëviznin me masa të forta sigurimi, forcat partizane i shtuan sulmet e tyre. Disa ditë më pas komanda e Korpusit XXI vërente se “në zonën Tiranë-Elbasan sulmet e befasishme po shtohen”.

Sulme të vijueshme në të gjithë zonën...

Gjatë muajt tetor 1943, përveç sulmeve gjatë rrugëve, partizanët ndërmorën edhe disa aksione në kryeqytet:



shkatërruan në Tiranë dy posta xhandarmërie në afërsi të Varrit të Bamit; goditën me zjarr një repart ushtarësh nazistë në stërvitje brenda në kazermat e xhenios; në lindje të Tiranës kapën tre kamionë të një reparti armik që u orvat të çante rrugën e Priskës, të bllokuar nga batalionet e qarkut të Tiranës. Në këtë kuadër ishte edhe goditja me top, më 18 tetor 1943, nga artileria e BrllIS, e “asamblesë së tradhtarëve” e mbledhur në Tiranë. Me këtë rast komanda e Korpusit XXI gjerman shkruante në ditarin e vet: “Veprimtaria e çetave në Tiranë është bërë e padurueshme, gjendja përreth po bëhet gjithnjë e më kërcënuese. Kodrat e Tiranës janë mbushur me armiq”. Për t’u hakmarrë ndaj partizanëve, nazistët ndërmorën një sulm të posaçëm duke hedhur në veprim forca më të mëdha, sidomos duke vënë në përdorim një grup të tërë artilerie dhe aviacionin luftarak. Partizanët e BrllIS dhe të Grupit të Pezës, të cilët kishin shkuar aty për t’u mbërthyer në luftë frontale me gjermanët kishin marrë me kohë masa për t’u larguar nga ky rajon. Me fillimin e tërheqjes, forcat partizane i bënë një rezistencë ushtrisë naziste që mësynte në tri kolona: nga ura e Farkës, nga kodrat e

Saukut dhe nga ura e Beshirit. Armiku me këtë veprim kërkonte të rrethonte forcat partizane, por nuk ia arriti qëllimit. Kur kolonat armike kishin arritur të mbyllnin unazën e rrethimit, luftëtarët çlirimtarë që ndodheshin në këtë rajon, qenë larguar në bregun e majtë të lumit Erzen. Forcat operuese gjermane u kthyen po atë ditë në Tiranë duke i raportuar komandës eprore se “vetëm i dëbuan partizanët”, kurse për “asgjësimin e tyre nevojitet një operacion në shkallë të gjerë”. Më 20 tetor, partizanët e Pezës e kapën prapë rajonin që kishin lëshuar një ditë më parë. Ndërkaq, BrllIS e zgjeroi veprimtarinë luftarake drejt jugut në rajonin e Kërrabës e të Peqinit dhe mori detyrë për të mbrojtur rrugën Elbasan-Tiranë dhe Elbasan-Peqin.

Për Luftën e Arbanës gjatë kësaj periudhe nga historiografia është shkruar në vijimësi dhe është përkujtuar si ngjarje, por duke e lidhur këtë luftë dhe me formimin e BrllIS. Në fshatin Arbanë është ngritur lapidari që përkujton këtë ngjarje dhe organizimin e brigadës, si dhe Luftën e Arbanës, si ndeshja e parë e madhe me pushtuesit nazistë gjermanë në qarkun e Tiranës, ka zënë vend në Fjalorin Enciklopedik shqiptar dha atë ushtarak.



Kur MASHTRIMI

bëhet armë: Nga Troja te Lufta e Dytë Botërore

Gjatë gjithë historisë, luftërat janë përcaktuar nga taktikat e guximshme dhe fuqia ushtarake.

Megjithatë, metoda të improvizuara, befasuese dhe ndonjëherë të çuditshme kanë luajtur gjithashtu role vendimtare në formësimin e konflikteve në mbarë botën.

Nga truket psikologjike, te mashtrimet gjeniale dhe aleancat e pazakonta, këto metoda jo konvencionale kanë ndikuar ndjeshëm në rezultatet e luftërave.

1 *Mashtrimi me Kalin e Trojës*

Përdorimi nga grekët i një kali prej druri për të depërtuar në Trojë është arketipi i dredhisë ushtarake. Duke fshehur ushtarë elitarë brenda tij, grekët mashtruan trojanët, duke sjellë rënien e qytetit, një mësim i përjetshëm mbi luftën psikologjike.



2 *Operacioni Fortitude: Ushtria e rreme e Zbarkimit në Normandi*

Para Zbarkimit në Normandi, Aleatët përdorën Operacionin Fortitude për të mashtruar nazistët mbi vendndodhjen e pushtimit.

Ky mashtrim i ndërlikuar përfshinte krijimin e një ushtrie fiktive nën komandën e gjeneralit Patton, me tanke plastike, mjete zbarkimi false dhe trafik radio të rremë. Masat bindën gjermanët se sulmi kryesor do të ndodhte në Calais, duke ndihmuar suksesin në Normandi.



3 *Taktikat kamikaze në Luftën e Dytë Botërore*

Pilotët japonezë kryen sulme kamikaze ndaj anijeve aleate në Paqësor, duke sakrifikuar jetën për të dëmtuar

anijet luftarake.

Edhe pse të dëshpëruara, këto taktika detyruan krijimin e masave të reja mbrojtëse në det dhe tronditën forcat kundërshtarë.



4 *Elefantët e luftës së Hanibalit*

Gjenerali kartagjenas Hanibali udhëhoqi elefantë lufte përmes Alpeve për të goditur Romën, duke tronditur trupat armike që nuk i njihnin këto kafshë gjigante. Megjithëse shumë elefantë ngordhën rrugës, ndikimi psikologjik mbi ushtarët romakë ishte i madh.



5 *Ushtria fantazmë e Luftës së Dytë Botërore*

E përbërë nga artistë dhe inxhinierë zëri, "Ushtria Fantazmë" e SHBA-së përdori mashtrime zanore, automjete plastike dhe transmetime të rreme radio për të mashtruar gjermanët mbi lëvizjet e trupave aleatë. Iluzionet e tyre shpëtuan mijëra jetë.



6 *Truket e Navigimit të Grupit të Shkretëtirës me Rreze të Gjatë*

LRDG-ja britanike navigonte shkretëtirat e gjera të Afrikës së Veriut, duke përdorur teknika novatore për t'i shmangur patrullat e Boshtit.

Ata përdornin busullën diellore të Bagnoldit dhe vrojtimet me yje me teodolit për pozicionim të saktë. Për të mashtruar armiqtë, krijonin gjurmë të rreme dhe manipulonin mirazhet për të fshehur lëvizjet.



7 Kukullat e rreme të parashutistëve: Operacioni "Titanik"

Gjatë pushtimit të Normandisë, Aleatët hodhën qindra "parashutistë" manekin larg zonave reale të zbarkimit, duke tërhequr vëmendjen gjermane dhe duke përhapur panik. Konfuzioni ndihmoi operacionet ajrore të vërteta.



8 Formacioni Testudo i Romakëve

Legjionet romake shpikën formacionin "testudo", duke përdorur mburoja të mbivendosura për t'u mbrojtur nga shigjetat dhe predhat.

Kjo taktikë mbrojtëse u dha romakëve mundësinë të afroreshin te fortifikimet me humbje minimale.



9 Sulmet e befasishme në llogore dhe taktikat "Toka e askujt"

Gjatë Luftës së Parë Botërore, njësi të specializuara kryenin sulme surprizë natën, duke kaluar zonën e asnjërit dhe duke depërtuar në llogoret armike.

Duke përdorur armë të improvizuara si shkopinj luftime, ata mblidhnin informacione, kapnin robër dhe ngrinin moralin përtej mbrojtjes statike.



10 Gazi helmues në Luftën e Parë Botërore

Përdorimi i parë i madh i gazit helmues në Ypres më 1915 shkaktoi tronditje në luftë. Sulmet kimike anashkalonin mbrojtjet tradicionale, krijonin kaos dhe çuan në zhvillimin e maskave dhe kundërmasave të dëshpëruara.



TETORI
rozë
TETORI
rozë

REVISTA "Mbrojtja"

botim i Ministrisë së Mbrojtjes